

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023*

6.04.2023
Ora 12.04

RENDI I DITËS

**“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 46, datë 04.04.2023 të
depozituar nga z. Çlirim Hoxha”**

PJESËMARRJA:

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Parti politike:** Z. F. Nuri (Bashkimi për Fitore)
- **Të tjerë:** Z. Ç. Hoxha, KZAZ-ja nr. 72,

Z. I. Rusmali: Çelim seancën e shqyrtimit paraprak për kërkesën ankimore nr. 46, të paraqitur nga zoti Çlirim Hoxha, i cili kandidon në Bashkinë Devoll, si kandidat i pavarur. Prezent në këtë seancë është ankuesi. Ju lutem, bëni prezantimin.


Z. Ç. Hoxha: Çlirim Hoxha, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit.

Z. I. Rusmali: Prezent gjithashtu është ...

Z. R. Cane: Roland Cane, kryetar i komisionit.

Z. I. Rusmali: Kryetar i KZAZ-së nr. 72, Devoll. Prezent tjetër është...

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023*

Znj. E. Haxhi: Enida Haxhi, sekretare e KZAZ-së nr. 72, Devoll.

Z. I. Rusmali: Dhe gjithashtu nga komisioni...

Z. J. Mejka: Jetnor Mejka, zëvendëskryetar komisioni.

Z. I. Rusmali: Tjetër ka?

Z. D. Zaçi: Dritan Zaçi, anëtar komisioni.

Z. I. Rusmali: Tjetër?

Z. Sh. Cani: Shkëlqim Cane, anëtar komisioni.


Z. B. Kanina: Bledar Kanina anëtar i KZAZ-së.

Z. I. Rusmali: Gjithashtu, informohem nga administrata se ka një kërkesë për të marrë pjesë në këtë seancë si palë e interesuar nga ana e subjektit “Bashkë fitojmë”. Ju lutem.

Z. F. Nuri: Franci Nuri, përfaqësues i subjektit “Bashkë fitojmë”.

Z. I. Rusmali: Prezent është edhe Sekretari i Përgjithshëm dhe stafi i KQZ-së, që asiston Komisionin tonë në raste të tilla. Ne duhet të shqyrtojmë kërkesën paraprake? Ju lutem, prezantoni kërkesën tuaj siç e keni paraqitur.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*


2

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023*

Z. F. Nuri: Brenda afatit ligjor ne kemi paraqitur pranë KQZ-së kërkesën për marrjen pjesë si palë e interesuar në shqyrtimin e çështjes së ankimit në KAS të ankuesit, zotit Çlirim Hoxha, ankimin ndaj vendimit nr. 19, datë 29.3.2023 i KZAZ-së nr. 72, Bashkia Devoll. Rezulton që me vendimin nr.72, datë 3.4.2023 KZAZ-ja e Bashkisë Devoll me shkresën nr. 44 dhe me vendimin e saj nr. 19, datë 29 mars 2023 ka njoftuar palën e interesuar, kandidatin e propozuar nga zgjedhësit për kryetar të qeverisjes vendore, zotin Çlirim Fatmir Hoxha, se në rastin e shqyrtimit të kërkesës së tij, po citoj: “Na ka arritur të dalë me një vendim për regjistrimin, pasi rezultati është 3 vota pro dhe 3 vota kundër”. Rezulton se zoti Çlirim Hoxha ka paraqitur në KAS ankim ndaj këtij vendimi dhe ne jemi informuar se sot në datën 6.4.2023 në orën 12 do të kishte seancë në KAS. Nisur nga parashikimet e nenit 133 të Kodit Zgjedhor, i cili parashikon që në shqyrtimin e ankimit nga KQZ-ja kanë të drejtë të marrin pjesë edhe palët e interesuara, dhe palët e interesuara, sipas ligjit, është çdo subjekt zgjedhor, të drejtat dhe interesat e ligjshme të të cilit, qofshin këta individualë, ose të përbashkët, prekin ose ka të ngjarë të preken nga vendimi që mund të jepet në fund të procedurës, ne si koalicion kemi gjykuar të arsyeshme të paraqesim kërkesë për ndërhyrje dhe për të qenë prezent. Arsyet konkrete, sepse kjo ishte pjesa hyrëse, janë sepse zoti Çlirim Hoxha rezulton të jetë një kandidat që pretendon se do të garojë si i pavarur për Bashkinë Devoll, por kandidati ynë e ka ndjekur rastin nga afër dhe pas verifikimeve në terren, ka dyshime të arsyeshme dhe rezulton se një pjesë e qytetarëve që kanë nënshkruar firmat në mbështetje të zotit Hoxha, disa prej tyre kanë deklaruar përpara noterit për shkelje duke pretenduar se firmat e tyre mund të jenë të falsifikuara. Dhe këto nuk janë thjesht dhe vetëm pretendime, por kandidati i koalicionit tonë “Bashkë fitojmë”, dhe këtu është edhe interesi ynë, ka bërë kallëzim në prokurorinë e Korçës. Për më tepër gjej me vend

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023*

që të informojmë KAS-in edhe për një dokument të rëndësishëm, nuk e di nëse është vendosur në dispozicion, dokument nga prokuroria e shkallës së parë Korçë, i datës 5.3.2023 nëpërmjet të cilit vërtetohet që Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë ka regjistruar kallëzim penal nr. 431 të vitit 2023 mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit Elvis Hajdërlli, që është kandidat i koalicionit “Bashkë fitojmë” në ngarkim të shtetasve Çlirim Hoxha dhe Enkelejd Imira, për veprën penale falsifikim të materialeve zgjedhore dhe rezultateve të zgjedhjeve. Ne patjetër si koalicion në parim jemi që gjithkujt të mos i ndalohet e të gjithë kanë të drejtë të kandidojnë si partiakë apo si të pavarur, se është një e drejtë e patjetërsueshme, por jo me manipulime dhe jo me shkelje ligji. Pra, së pari, interesi unë vërtetohet me faktin që kandidati ynë është ai që e ka ndjekur rastin konkret, ka evidentuar shkeljet, ka kontaktuar qytetarët, qytetarët kanë nënshkruar te noteri deklaratat përkatëse ku vërtetohet që nuk kanë firmosur në mbështetje të kandidatit të pavarur. Së dyti, kallëzimi penal është regjistruar po nga kandidati unë, është depozituar dhe është regjistruar sikundër e relatuar dhe, së treti, ne kemi interes si subjekt, sepse ky është një rast i veçantë, ku kemi përballë një kandidat që pretendohet që ka mbledhur firma të falsifikuara për të kandiduar si kryetar bashkie dhe jemi këtu për të mbrojtur jo vetëm interesin e zgjedhësve tanë, por edhe të të gjithë zgjedhësve në përgjithësi për të mbrojtur ligjshmërinë e procesit zgjedhor, garën e ndershme, të barabartë mes palëve garuese në zgjedhje. Shkurtimisht e përfundimisht kërkojmë nga KAS-i që të përfshijë koalicionin “Bashkë fitojmë” si palë e interesuar në këtë shqyrtim për vendimmarrjen lidhur me ankimimin e zotit Çlirim Hoxha. Faleminderit!

Z. I. Rusmali: Faleminderit! Zoti Hoxha, keni ndonjë reagim lidhur me këtë kërkesë që është paraqitur përpara nesh?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 6.04.2023

Z. Ç. Hoxha: Jo, e pranoj kërkesën. Në qoftë se ka ndonjë kundërshtim për ato që tha, mund ta bëjë.

Z. I. Rusmali: Jo, jemi në pjesën formale të çështjes, nuk jemi te përmbajtja. Komisioni nuk ka çfarë thotë, ju jeni neutralë ndaj gjësë. Tërhiqemi për të marrë vendim për këtë? Në rregull. Do të na prisni 5 minuta sa të marrim vendimin për këtë kërkesë dhe pastaj do të vazhdojmë më tutje me procedurën.

Rifillon

Ora 12.17

Z. I. Rusmali: Rifillojmë seancën. KAS-i u mbledh dhe në dhomë këshillimi për shqyrtimin e kërkesës paraprake të paraqitur nga subjekti koalicioni “Bashkë fitojmë” vendosi rrëzimin e kërkesës për shkak se në praktikën e KAS-it e të Kolegjit Zgjedhor pjesëmarrja e subjekteve të treta në çështje që kanë lidhje me kërkesat për regjistrimin e një subjekti, konsiderohet se nuk justifikohet nga interesi i ligjshëm. Këtë praktikë kemi mbajtur edhe para dy ditësh me një çështje të Sarandës, ku kemi përjashtuar Partinë Socialiste, këtë praktikë ka mbajtur edhe Kolegji sa herë e ka shqyrtuar këtë rast. Do të na falni, por ju nuk mund t’ju kemi palë. Ju jeni të mirëpritur të rrini e ta ndiqni seancën, por si palë procedurale nuk mund të jeni. Seanca paraprake për shpjegim, është një seancë që merret me shqyrtimin e afatit të bërjes së kërkesës, me shqyrtimin e legjitimitit të palës për të bërë kërkesë dhe me shqyrtimin e kompetencës së KAS-it për ta marrë në shqyrtim këtë kërkesë. Pasi ne të trajtojmë e të zgjidhim bashkërisht këto tri çështje, do të ulemi eventualisht e do të trajtojmë themelin e çështjes, cili është konflikti real që ekziston atje dhe me

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023*

shpresë t'i japim zgjidhje. Tani për tani jemi vetëm në këtë fazë fillestare dhe faza fillestare fillon me prezantimin e Sekretarit të Përgjithshëm për këto tre elemente që kërkojmë ne të trajtojmë. Zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore nr. 46 me ankues Çlirim Hoxha, kandidat i propozuar nga zgjedhësit për zonën zgjedhore Bashkia Devoll për kryetar bashkie. Objekti i ankimit është ankim kundër vendimit nr. 19, datë 29.3.2023 të KZAZ-së nr. 72 Bashkia Devoll. Nga verifikimi i elementeve formale të kërkesë konstatoj se dy elementet e para i plotëson kërkesa: kompetencën e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit administrativ, referuar edhe nenit 35, pika 5, të Kodit Zgjedhor, në rast se KZAZ-ja nuk arrin të marrë vendim brenda afatit përkatës, çështja i dërgohet brenda 24 orësh për shqyrtim KQZ-së nga kryetari i KZAZ-së, ose të paktën nga 2 anëtarë, ose mund të ankimohet në KQZ nga subjekti zgjedhor i interesuar. Edhe elementi i legjitimitetit plotësohet. Ajo që ngelet për të parë është aspekti i afateve ligjore të ankimit pasi ankimi, në qoftë se mund të quhet vendim, mban datën 29.3.2023 dhe është paraqitur në KQZ në 04.04.2023. Ideja është që kur e ka marrë në dorëzim ose kur është njoftuar për këtë vendim ankuesi Çlirim Hoxha. Kjo vlen për t'u diskutuar. Mendoj që çështja duhet të kalojë për shqyrtim dhe i propozohet KAS-it për shqyrtim, por si kërkesë e ardhur nga kryetari i KZAZ-së pasi nuk është marrë vendim për këtë çështje.

Z. I. Rusmali: Dakord. Ndoshta kjo duhet sqaruar paraprakisht para se të fillojmë dhe ndoshta është ky momenti, sepse jemi në rastin e një mosvendimi jo të një vendimi. Pra, praktikisht ankimi është ankim ndaj një mosvendimi dhe është rast i veçantë, i çuditshëm, në fakt, deri në njëfarë mase, po realiteti të përball me çfarëdolloj problemi. Neni 35 i Kodit Zgjedhor parashikon që në rastet e mosmarrjes

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023*

së vendimeve, kompetenca i kalon KQZ-së. Nga ana e Komisionerit ka ndonjë procedurë të filluar për këtë çështje, që ne të mos krijojmë përplasje brenda për brenda institucionit?

Z. Y. Merkaj: Jo, nga ana e Komisionerit nuk ka asnjë praktikë të tillë, që të këtë marrë dhe të këtë shpallur, ose të këtë miratuar listat, ose kandidaturat e KZAZ-ve, që janë nga bashkitë që janë, Referuar nenit 19 të Kodit Zgjedhor nuk parashikohet në asnjë pikë të nenit kompetenca e Komisionerit për të shqyrtuar ankimet ose vendimet e KZAZ-ve.

Z. I. Rusmali: Ju thoni që KAS-i mund ta marrë në shqyrtim, në zbatim të pikës 5 të nenit 35, siç e kuptova unë.

Z. Y. Merkaj: Po fakti që thotë brenda 24-orëshit e merr për shqyrtim në KQZ dhe ankimi bëhet në KQZ, mendoj që është neni 21 i Kodit Zgjedhor, “kompetencat e KAS-it për ta marrë në shqyrtim”.

Z. I. Rusmali: Mirë, ia japim fjalën ankuesit të flasë dhe ai vetëm për këto çështje, të lutem.

Z. Ç. Hoxha: Vetëm për afatin.

Z. I. Rusmali: Për afatin, për legjitimitimin tuaj dhe për kompetencën tonë.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023*

Z. Ç. Hoxha: Në lidhje me afatin, vendimi është marrë në datën 29.03.2023, kurse mua njoftimi, me shkresë zyrtare, më ka ardhur në datën 03.04.2023. Këtë kam marrë vendim zyrtar, është edhe me numër protokolli 44, lënda “Njoftim mbi vendimmarrjen e KZAZ nr, 72 në lidhje me shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësi për kryetar bashkie, zoti Çlirim Hoxha” dhe pastaj është vendimi bashkëngjitur shkresës përcjellëse.

Z. I. Rusmali: Në vlerësimin tuaj afati fillon nga data e njoftimit.

Z. Ç. Hoxha: Nga data 03.04.2023, sepse atëherë e kam marrë informacionin.

Z. I. Rusmali: Për çështjet e tjera, keni ndonjë gjë për të thënë, apo jo? S’e keni të domosdoshme, në fakt.

Z. Ç. Hoxha: Jo.

Z. I. Rusmali: Mirë, tani Komisionit unë s’i kërkoj dot të mbajë qëndrim, po shpjegime mund të na japë për këtë çështjen e afatit, apo jo? Mendoni? Kryetari i Komisionit, ju lutem, na sqaroni pak këtë çështjen e afateve.

Z. R. Cane: Atëherë, KZAZ –ja nr.72 në mbledhjen e datës 28, më falni, 29, ka dalë me vendim, me 4 vota pro dhe 3 kundër, për ta regjistruar kandidatin. Kjo është e shënuar në protokoll. Tani, për mungesë të bazës materiale, se nuk kishim fotokopje dhe kompjuter për të shkruar, për ta nxjerrë nga sistemi vendimin dhe për ta printuar,

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023*

iu la detyrë sekretares për ta sjellë vendimin, që ta nënshkruanin të 7 anëtarët e Komisionit. Nga ana e sekretares, zbardhja e vendimit u bë ditën e nesërme, në orën 12, na u sollën për t'u firmosur. Në atë moment njëri nga anëtarët e komisionit nuk ndodhej në qytet, sepse ishte me punë në një qytet tjetër dhe ky vendim ngeli pa u nënshkruar nga të 7-të, por u firmosën 3 pro 3 kundër, kurse i shtati nuk ndodhej në qytet, ishte jashtë qytetit. Për këtë arsye vendimi doli pa vendim, por në protokoll është shënuar që me 4 vota pro dhe 3 kundër në mbledhjen e KZAZ-së është pranuar regjistrimi. Meqenëse vendimi ngeli 3 me 3, unë brenda asaj dite materialet bashkë me vendimet për subjektet e tjera politike i kam sjellë dhe i kam protokolluar pa kaluar 24 orë, kurse nga ana e sekretares është shkëlur neni 34 pika "Ë", ku thuhet që subjekteve duhet t'u jepen brenda 24 orëve kopje të vërtetuara të vendimeve të KZAZ-së. Unë i kam kërkuar në datën 3 prill sekretares të vinte urgjent dhe të njoftonte kandidatin dhe në datën 3 në orën 5 mbas dite jemi mbledhur me urgjencë për t'i dhënë shkresën subjektit. Kjo ishte detyra e sekretares, prandaj ndodhi ky keqkuptim.

Z. I. Rusmali: Tani, nuk e di në qoftë se kolegët do të kenë pyetje dhe duan të thellohen, është e drejta e tyre, po unë do të preferoja, dhe mendoj se i bën mirë seancës, që neve të mos ta shndërrojmë në një seancë kundër sekretares, se me sekretaren merret tjetër kush, nuk merremi ne. Ne kemi për të shqyrtuar këtë ankimin dhe në qoftë se sqarohet sa më mirë kjo çështja e afateve, besoj që ju na ndihmoni jashtë mase, pastaj përgjegjësitë e njërit apo të tjetrit, nuk janë të kësaj seance. Ju po doni mund t'i diskutoni, po unë besoj se nuk i takojnë kësaj seance.

Z. K. Bele: Kisha vetëm një pyetje, nuk e kuptova, kur u mbledhët më pas, pse nuk

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*


9

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023*

firmosi ai zotëria, që ju thoni se është dakord? Këtë s'e gjeta dot.

Z. R. Cane: Në momentin që na u soll vendimi për ta nënshkruar ishin prezent vetëm 6 anëtarë të komisionit, i shtati nuk ishte, se ndodhej jashtë qytetit, sepse ne në mbrëmje, një ditë më përpara, e miratuam dhe është e nënshkruar në protokoll, të nesërmen ai nuk ishte, nuk ndodhej, për arsyen e tij, dhe mbas kësaj ai ka dhënë dorëheqjen, nuk ka ardhur më. Nuk e di arsyen pse ka dhënë dorëheqjen, është një anëtar i KZAZ-së nga Partia Socialdemokrate.

Z. I. Rusmali: Është këtu sot?

Z. R. Cane: Jo, ai ka dhënë dorëheqjen dhe është bërë propozimi për ta zëvendësuar, nuk e di deri në ç'fazë është.

Z. I. Rusmali: Dakord.

Z. L. Braho: Tani ju i referoheni librit të protokollit dhe unë kam një kopje këtu që kanë nënshkruar të gjithë përveç një anëtari. Pra, kanë nënshkruar kryetari, zëvendëskryetari dhe 4 anëtarë. Njëri që është me numrin 3 në procesverbal nuk ka nënshkruar. Në qoftë se i referoheni këtij si libër protokollit ju?

Z. R. Cane: Të gjithë kemi nënshkruar, të shtatë.

Z. L. Braho: Po kjo që kam unë këtu është...

Z. R. Cane: Ne kemi origjinalin këtu.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023*

Z. L. Braho: Po, sekretarja.

Znj. E. Haxhi: Për të sqaruar më tepër rrethanat dhe faktet e ngjarjes, nuk e di nëse është momenti për të depozituar dokumentet dhe provat, unë kam sjellë me vete dokumentet origjinale, librin e protokollit, vendimin origjinal dhe ato që i disponoj në fotokopje i kam legalizuar me vulë sekretarie. Nuk e di nëse është momenti për t'i paraqitur dhe ta verifikoni librin origjinal.

Z. L. Braho: Sa firma ka aty, 7 apo 6 firma?

Znj. E. Haxhi: Ta depozitoj?

Z. R. Cane: Te pjesa e vendimit janë 7.

Z. I. Rusmali: Më duket sikur po futemi te thelbi i gjësë, ndërkohë që nuk na duhet thelbi i gjësë, na duhet vetëm kjo çështje. Sekretarja ka ndonjë gjë për të thënë për këtë çështjen e afatit, të lutem?

Znj. E. Haxhi: E gjithë vendimmarrja është realizuar brenda afatit. Në datën 27 është bërë mbledhja e Komisionit, pra, e KZAZ-së nr.72. ..

Z. I. Rusmali: 29

Z. R. Cane: 27 ishte afati i dorëzimit të dokumenteve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

**Zbardhi materialin audio
Alma KOLA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023*

Znj. E. Haxhi: Kanë marrë pjesë pothuajse të gjithë anëtarët e KZAZ-së, ku kanë nënshkruar në fund. Në disa faqe kanë nënshkruar të gjithë, kurse në faqen e fundit kanë nënshkruar vetëm dy prej tyre, që do të thotë se mbledhja e KZAZ-së nuk ka arritur në një përfundim për vendimmarrje. Në librin e protokollit janë shënuar të gjitha mendimet e anëtarëve, ku kanë shpjeguar votën pro dhe kundër. Pra, kanë votuar pro ose kundër dhe kanë shpjeguar edhe arsyet pse nuk janë dakord që kandidati të regjistrohet në zgjedhje. Libri i protokollit është mbajtur nga ime dhe unë kam shënuar për secilin mendimet e tyre. Në atë mbledhje nuk është arritur një vendimmarrje, pavarësisht se ishin 7 anëtarë, pra ishte i plotësuar kuorumi. Anëtari i shtatë, siç mund ta verifikoni edhe në mbledhjen e protokollit, nuk ka dhënë asnjë deklaram. Verifikohet pra, të gjithë kanë folur me emër dhe mbiemër, pra, unë kam shënuar emrin dhe mbiemrin e secilit anëtar dhe se çfarë kanë thënë ata.

Z. I. Rusmali: Të lutem, edhe një herë: mos u merr me thelbin e gjësë, sepse do të merremi më vonë, në qoftë se do të merremi.

Znj. E. Haxhi: E kuptoj po anëtarët e tjerë dhe personat e interesuar janë marrë me thelbin dhe unë doja të shtoja rreth thelbit.

Z. I. Rusmali: Çështja është shumë e thjeshtë. Ka një procedurë që e keni bërë në datën 29, ka edhe një dokument që e keni lëshuar në datën 3. Kandidati është ankuar mbështetur në dokumentin e datës 3. Këtë duhet të na thoni! Domethënë, çfarë vlere ka dokumenti i datës 3 për procedurën?

Znj. E. Haxhi: Në datën 28 jemi munduar të zbardhim vendimin e mbledhjes të një dite më parë. Pra, është marrë vendimi dhe të nesërmen ky vendim, së bashku me vendimet e tjera, të shqyrtimit të kërkesave të kandidatëve të tjerë, është dërguar me

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023*

protokoll pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Të nesërmen, në datën 28, është marrë vendimi ose mosvendimi, nuk e di si do të quhet, mosvendimi, sepse nuk është arritur kuroumi i duhur. Ky vendim është përcjellë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të nesërmen. Janë depozituar nga kryetari i KZAZ-së së bashku dhe me dokumentacionin e kandidatëve të tjerë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në lidhje me njoftimin për kandidatin, kandidati është vënë në dijeni, ashtu sikurse e ka sjellë dorazi dokumentacionin e paraqitur në KZA-së dhe po ashtu ka marrë edhe njoftimin. E kemi njoftuar se është në kushtet e këtij vendimi, të këtij rezultati pra. Më vonë ka kërkuar shkresërisht që ne ta bëjmë me shkresë. Ka kërkuar më datën 03.034, dhe po në datën 03.04 unë kam bërë njoftimin për vendimmarrjen e KZAZ-së pra në momentin kur e ka kërkuar për të paraqitur ankimin. Pra, e ka kërkuar me arsyen se do të bëjë ankim në KAS dhe po për këtë arsye i është njoftuar në datën 03.04. ndërsa KQZ-ja është njoftuar që në datën 29 mars.

Z. I. Rusmali: Dakord, kjo e bën të qartë.

Z. L. Braho: Tani, që të qartësohemi, ditën që ju nuk keni arritur të bëni këto 4 votat zoti Çlirim Hoxha a ka qenë i pranishëm në mbledhjen e KZA-së? Se mbledhjet e KZAZ-së janë publike. A ka qenë i pranishëm në momentin që ju nuk keni arritur dot të merrni vendim?

Znj. E. Haxhi: Jo nuk ka qenë asnjë kandidatët që kanë paraqitur kërkesë për regjistrim.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023*

Z. L. Braho: Po ju, kur ia keni njoftuar verbalisht që po thoni se ia keni njoftuar verbalisht dhe ai pastaj për shkak të ankimit që donte të bënte ju është drejtuar ju me shkrim?

Znj. E. Haxhi: Verbalisht ia kemi njoftuar që në datën 28 kur kemi marrë vendimin. Janë njoftuar të gjithë kandidatët, sepse kandidatët interesohen për vendimmarrjet që merr KZAZ-ja. Dhe të gjithë telefonohen është njoftuar që po, ndaj teje kemi marrë vendim. Në rastin e zotit Çlirim Hoxha i kemi thënë që jo ndaj teje nuk është marrë vendim, sepse ndaj teje votat kanë qenë 3 dhe kundër për shkak të dokumentacionit të falsifikuar që ne kemi vërtetuar që në momentin kur kemi bërë mbledhjen e datës 27. Aty janë edhe pretendimet e anëtarëve të KZAZ-së ku kanë deklaruar votën edhe pse votojnë kundër. E kanë deklaruar për këtë shkak, pra për shkak të falsifikimit.

Z. L. Braho: Zoti Hoxha, ju kur e keni marrë vesh? Përveç kësaj shkresës a keni marrë vesh ndonjë moment tjetër?

Z. Ç. Hoxha: Nuk kam qenë i informuar për këtë rezultat, por më thanë që më datën 28 kanë votuar 4 me 3, dhe presim përgjigje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Dhe pastaj më vjen shkresa që ndaj juve nuk është marrë një vendim për regjistrim ose mosregjistrim. Kjo më ka ardhur me datën 03.04.2023. Unë doja të shtoja diçka që përderisa KZAZ-ja nr. 72 Devoll është pjesë e administratës publike duhet at ushtrijë veprimtarinë e saj nëpërmjet akteve administrative, sepse nuk mund të gjendet një provë e saktë ose një fakt kur unë e kam marrë njoftimin, sepse unë mund të them që nuk e kam marrë njoftimin dhe tregohem i sigurt që nuk e kam marrë

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023*

një njoftim verbal, edhe sekretarja në perceptimin e saj mund të thotë se më ka njoftuar, por, në fakt, gjëja më e saktë do të ishte që sekretaria ose KZAZ-ja numër 72 Devoll të shprehej me një njoftim, me një akt administrativ ku të më thuhej se procesi yt ka qenë deri këtu dhe unë duke u mbështetur mbi këtë akt administrativ të vazhdoja hapat e mëtejshëm. Dua të sqaroj dhe diçka, verimi i KZAZ-së nr. 72 është në kundërshtim me neni 35.

Z. I. Rusmali: Ju lutem, mos na futni në nene.

Z. Ç. Hoxha: Nuk kam qenë i pranishëm.

Z. L. Braho: Ju keni qenë në dijeni që do të shqyrtohej kërkesa juaj në datën 28.

Z. Ç. Hoxha: Jo, nuk kam pasur dijeni.

Znj. E. Haxhi: A mund të shtoj diçka, ju lutem? Të nderuar anëtarë, në gjykimin tim, e rëndësishme është që këtu të përcaktohet se kur ka marrë dijeni personi i interesuar. Personi i interesuar pra pretendenti për kandidat për kryetar bashkie sapo e konfirmoi që është njoftuar se në mbledhjen e datës 27 kanë votuar pro 4 anëtarë, pastaj të nesërmen anëtari tjetër është tërhequr. Pra, sapo e tha. Kështu që ai ka marrë dijeni, është njoftuar. Pavarësisht formës, që lë vend për diskutim. Por e rëndësishme është, që siç e pranoi edhe vetë, ai është njoftuar përderisa ka pasur dijeni për rezultatin e votimit sipas pretendimit të tij 4 me 3 ose 3 me 3, sikurse rezulton.

Z. I. Rusmali: Juve thatë që nuk ka pasur votim 4 me 3.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023*

Znj. E. Haxhi: Jo.

Z. I. Rusmali: Juve po vetë keni shkruar në librin e protokollit të mbledhjeve hidhet në votim në KZAZ, dhe me 4 vota pro dhe 3 kundër kandidati regjistrohet.

Znj. E. Haxhi: Këto janë fjalët e kryetarit, zotit Roland Cane. Pra është pohim. Votimi nuk u bë. Nëse do të ishte bërë votimi, ajo fleta e fundit e protokollit...

Z. I. Rusmali: Ju lutem, ju si sekretare jeni aty për të shkruar fjalët e të tjerëve jo tuajat. Ju nuk keni asnjë kompetencë.

Znj. E. Haxhi: E kuptoj, unë kam shkruar fjalët e kryetarit. Ai ka thënë këtë pohim që 4 me 3 regjistrohet.

Z. I. Rusmali: Të lutem mos nxito. Këto fjalë janë thënë nga kryetari apo kryetari i ka shpikur këto fjalë?

Znj. E. Haxhi: Kryetari i ka thënë. Është pohim, por ky nuk është rezultat votimi. Pohimi dhe rezultati i votimit...

Z. I. Rusmali: Të lutem kryetari në kompetencën e vet ka shpallur vendimin e komisionit, apo jo?

Znj. E. Haxhi: Jo.

Z. I. Rusmali: Ka dhënë mendimin e vet?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023*

Znj. E. Haxhi: Po ka dhënë mendimin e tij në kuadër të pretendimeve që kanë dhënë të gjithë.

Z. I. Rusmali: Votat nuk ishin kështu?

Z. I. Rusmali: Jo votat nuk ishin ashtu, sepse fjalia e fundit e mbledhjes është me...

Z. I. Rusmali: A pati kontestime nga ndonjë nga anëtarët?

Znj. E. Haxhi: Po, patjetër. Insistoj në këtë...

Z. I. Rusmali: Të lutem më dëgjo pak mua. Ku është në protokoll shënimi për kontestimet nga ana e anëtarëve?

Znj. E. Haxhi: Është anëtari i KZAZ-së Dritan Paçi, me këtë fjali mbyllet edhe libri i protokollit, ku thotë që nuk ka folur Joneli, i referohet Jonel Bylykbashit, anëtarit të 7-të. Deh ai faqen e fundit nuk e ka nënshkruar, sepse nuk u arrit në votim. Anëtarët nuk votuan. Nëse do të kishin votuar, faqja e fundit do të ishte mbyllur me nënshkrimet e të gjithë anëtarëve dhe të gjithë ata do të deklaronin votën pro ose kundër.

Z. I. Rusmali: Dakord. Zaçi ka thënë se Joneli nuk ka folur, por nuk ka thënë që Joneli nuk ka votuar.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023*

Znj. E. Haxhi: Nuk ka folur, ai nuk ka shtruar asnjë mendim. Edhe në faqet e tjera të protokollit vërehet se ai nuk ka shprehur asnjë mendim pro ose kundër.

Z. I. Rusmali: Nuk ka thënë që nuk ka votuar, ka thënë që nuk ka folur.

Znj. E. Haxhi: Po ne nuk ishim në atë fazë të vendimmarrjes, nuk kishim kaluar ende për votim, prandaj nuk ka thënë ashtu.

Z. I. Rusmali: Joneli ka firmosur pikërisht faqen ku deklarohet nga kryetari vota. Dhe është firmosur nga të 7-të. Këto janë materialet tuaja, nuk janë tonat. Tani, ku del këtu, në këtë protokoll, fakti që komisioni nuk ka marrë dot vendim.

Znj. E. Haxhi: Në bazë të nenit 35, pika 3, vendimet e KZAZ-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët dhe secili prej anëtarëve deklaron, krahas nënshkrimit, citohet në ligj, votën pro ose kundër. Ai nuk e ka deklaruar në asnjë moment, as te fjalët, në ato që unë kam mbajtur shënim nga ato që ka thënë, dhe as te nënshkrimi, siç e kërkon neni 35, pika 3. Pra, krahas nënshkrimit duhet të deklarohet edhe vota pro ose kundër. Siç shihet ai nuk ka bërë deklarinimin e votës.

Z. I. Rusmali: Votën kundër e kanë deklaruar vetëm 3 anëtarë.

Znj. E. Haxhi: Po.

Z. I. Rusmali: 4 të tjerët kanë shkelur ligjin?

Znj. E. Haxhi: Duhet ta deklaronin patjetër, sepse, nëse do t'i përmbahen strikt...

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023*

Z. I. Rusmali: Dakord, por në materialin tuaj 4 vetë nuk e kanë deklaruar? A kanë shkelur ligjin?

Znj. E. Haxhi: Unë nuk po pretendoj se kanë shkelur ligjin. Në kuadër të asaj mbledhjeje bëhet vendimi. Vendimi është akti administrativ.

Z. I. Rusmali: Pse do të thotë kjo se ka shkelur ligjin dhe nuk do të thotë që këta 4 janë pro?

Znj. E. Haxhi: Unë nuk po them që nuk kanë shkelur ligjin, unë po them nuk i janë përmbajtur citimeve të ligjit, ashtu siç duhet ta deklaronin. Edhe anëtarët e tjerë patjetër duhet të deklaronin pro ose kundër. Megjithatë anëtarët e tjerë, më falni se kjo është shumë e rëndësishme, anëtarët e tjerë kanë deklaruar në librin e protokollit arsyet, e kanë shpjeguar votën, pavarësisht se te nënshkrimi nuk kanë shënuar pro ose kundër, por në faqen e protokollit kanë thënë që janë pro ose kundër, përveç anëtarit të 7-të Jonelit, i cili nuk ka folur. Nuk e ka të nënshkruar në mbledhje as mendimin e tij, unë nuk i kam regjistruar fjalët e tij, por as kur ka nënshkruar nuk e deklaruar pro ose kundër dhe në këtë momente nuk kemi si ta gjykojmë nëse ishte pro ose kundër. Ai nuk e ka shprehur vullnetin.

Z. L. Braho: Kam një pyetje për kryetarin. Si e bëni procedurën e votimit ju aty në KZAZ, me fjalë apo me ngritje dore.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023*

Z. R. Cane: Me ngritje dore. Me 4 vota pro vendimi është miratuar dhe është shkruar në protokoll. E kam hedhur në votim e kam deklaruar votimin dhe kam deklaruar rezultatin e votimit me 4 vota pro dhe 3 kundër, kandidati miratohet.

Z. L. Braho: Në dijeninë tuaj pse nuk e ka nënshkruar vendimin Joneli?

Z. R. Cane: Sepse pengesë u bë sekretarja, nuk erdhi në moment formulari i vendimit për t'u nënshkruar. U soll të nesërmen në orën 12. Ky zotëria Joneli, të nesërmen nuk ishte në qytet, sepse punon në Korçë. Punon privat dhe nuk mund të largohet nga puna dhe ai nuk erdhi për ta firmosur. Pas kësaj meqenëse nuk i ndiqte dot mbledhjet e KZAZ-së ka dhënë dorëheqjen dhe pritet për t'u zëvendësuar. Ama është hedhur në votim dhe është shkruar në protokoll që është votuar 4 me 3.

Z. L. Braho: Sekretare, edhe nga ana juaj, si bëhet procesi i votimit aty me ngritje dore apo me të thënë: pro, kundër?

Znj. E. Hoxha: Me ngritje dore dhe pro dhe kundër, por në rastin konkret ne nuk kaluam në këtë fazë, sepse anëtari i 7-të në momentin që u vu në dijeni të deklaratave noteriale të falsifikuara, hoqi dorë dhe ka deklaruar se nuk e nënshkruaj. E ka thënë verbalisht dhe më tej nuk është paraqitur. Shkelja ligjore që pretendon kryetari se kam bërë unë, nuk është e vërtetë, sepse e thotë Kodi Zgjedhor që vendimet materializohen ose zbardhen të nesërmen e marrjes së vendimit, pra të nesërmen që bëhet mbledhja. Mbledhja është bërë më 27, dhe unë më datën 28 kam zbardhur të tria vendimet.



*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023*

Z. R. Cane: Me 28 dhe vendimin...

Z. I. Rusmali: E mbyllim këtu këtë debatin tuaj. A ka pyetje nga kolegët?

Ne duhet të tërhiqemi, sepse duhet të shkojmë në takim, besoj. Këtyre do t'ia lëmë në orën 3, apo jo?

Pyetje të tjera nuk ka ne duhet të mblidhemi dhe të marrim vendimin lidhur me nëse duhet ta pranojmë për ta marrë në shqyrtim apo jo. Këtë vendim do t'jua shpallim sot në ora 3. Do t'ju kërkoja të ishit prezent, sepse eventualisht, nëse do ta marrim në shqyrtim do të vazhdojmë me shqyrtimin. Nëse nuk do ta marrim në shqyrtim ju jeni të lirë të ikni, por na jepni këtë mundësi që ne të mos ju thërrasim një ditë tjetër, nëse do ta marrim në shqyrtim. A jeni dakord me këtë? Sot në ora 3.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.04.2023*

Rifillon seanca
Ora 14.50

Z. I. Rusmali: Riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore numër 46, të ankuesit Çlirim Hoxha me shpalljen e vendimit. KAS-i, pasi konsultoi çështjen e plotësimit të elementeve të formës së kërkesës ankimore, vendosi:

- Pranimin për shqyrtim të kërkesës, numër 46, datë 04.04.2023, të paraqitur nga kandidati i pavarur, zoti Çlirim Hoxha. Shqyrtimi do të bëhet menjëherë pas deklarimit, pas mbylljes së seancës paraprake.

- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

Këtu mbyllem seancën paraprake. I japim 5 minuta kohë stafit të bëjë gati pajisjet për transmetimin live dhe fillojmë direkt me seancën tjetër, kështu që nuk ka nevojë të lëvizni.

Vendimi nr. 51

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

P. [Signature]
22

RENDI I DITËS

Projektvendim: Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr. 47, objekti i ankimimit: “Kundërshtim i vendimit të KZAZ nr. 53, Përrenjas dhe ndryshimin e vendimit duke vendosur regjistrimin e zotit Vebi Hana. Ankues zoti Vebi Hana, kandidat për Kryetar Bashkie Përrenjas, propozuar nga Partia Uniteti Kombëtar”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** S’ka
- **Të tjerë:** Z. N. Muçmara, Z. S. Kopaçi, KRIIK

Z. I. Rusmali: Mirë, çelim seancën e shqyrtimit paraprak për ankimin numër 47 të kandidatit për Kryetar Bashkie të bashkisë Përrenjas zoti Vebi Tahir Hana. Kandidat i pavarur apo jo? Apo është subjekti? I subjektit “Partia e Unitetit Kombëtar”. Prezent janë anëtarët e KAS-it, prezent është administrata e KQZ-së me në krye Sekretarin e Përgjithshëm zotin Ylli Merkaj. Gjithashtu është prezent, ju lutem prezantohuni.

Z. N. Muçmara: Narti Muçmara kryetar i KZAZ-së 53, Përrenjas.

Z. S. Kopaçi: Saimir Kopaçi sekretar i KZAZ-së numër 53.

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.04.2023*

Z. I. Rusmali: Mirë, faleminderit që keni ardhur. Anëtarë të tjerë janë njoftuar apo ska pasur nevojë të vijnë. Dakord. Mungon ankuesi por nuk është e thënë, ne mund ta zhvillojmë edhe pa prezencë të palëve ankuese seancën tonë. Kështuqë ne mund të ecim përpara me shqyrtimin paraprak. Ju s'keni si të keni kërkesa paraprake. Kolegët kanë ndonjë deklaram për të bërë?

Z. E. Çefa: Jo.

Z. I. Rusmali: Ja japim fjalën Sekretarit të Përgjithshëm të na flasë për elementët që duhet të shqyrtojmë sot, të kësaj kërkesë.

Z. Y. Merkaç: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore numër 47 nga ankuesi Nebi Hana në të cilën kandidati për Kryetar Bashkie të Bashkisë Përrenjas propozuar nga "Partia Uniteti Kombëtar". I cili kundërshton vendimin e KZAZ-së numër 53 Bashkia Përrenjas datë 30.03.2023. Nga verifikimi i elementëve formalë të kërkesës konstatohet se dy elementët e parë plotësohen, ndërsa elementi i tretë i afatit, nuk plotësohet pasi është jashtë afatit tre ditor për të bërë ankimin kundër vendimit të KZAZ-së. Në këto kushte duke qenë se një nga elementët nuk plotësohet, në bazë të nenit 130 të Kodit Zgjedhor i kërkojmë KAS-it moskalimin në seancë administrative. Faleminderit!

Z. I. Rusmali: Po, faleminderit! Kolegët kanë ndonjë gjë për të thënë lidhur me këtë?

Z. E. Çefa: Problemi është që mos është si rasti tjetër që mund të pretendojë ai që e ka marrë njoftimin zyrtarisht më vonë.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.04.2023*

Z. I. Rusmali: KZAZ-ja ka bërë njoftim në datë 30 mars, ku ka deklaruar që nuk kemi regjistruar...

Z. K. Bele: Shkresa mu dha dorazi në 30.03 thotë...

Z. E. Lako: Jam paraqitur me datë 30 thotë dhe u njoha me vendimin..,

Z. I. Rusmali: Ndërkohë që ankimi është i datës 5. Ka ndonjë gjë tjetër për të thënë nga kolegët?

Z. E. Çefa: Jo!

Z. I. Rusmali: Mund ta mbyllim shqyrtimin paraprak? E mbyllim shqyrtimin paraprak. KAS-i i konsultuar ne vend konstaton se kërkesa ankimore është paraqitur jashtë afatit ligjor, për këtë arsye vendosi:

- Mospranimin për shqyrtim të kësaj kërkesë.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë brenda 5 ditësh nga shpallja e tij.
- Ky vendim shpallet sot nëpërmjet publikimit në faqen e internetit të KQZ-së dhe hyn në fuqi menjëherë.

Këtu e mbyllim këtë seancë. Ju falenderojmë ju që keni ardhur për pjesëmarrjen.

Vendimi nr. 49

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 45, me ankues Partia
“Aleanca Progresiste LZHK” me objekt, “Kundërshtim i vendimit të KZAZ nr.
53, Përrenjas, nr. 20, datë 30.03.2023, për mosregjistrimin e listës së kandidatëve
të LZHK-së për Bashkinë Përrenjas””.**

PJESËMARRJA :

KAS: Z. Elvin Lako, Z .Elvis Çefa, Z .Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.

Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj

Parti Politike: Aleanca Progresiste LZHK (F.Topollari)

Të tjerë: Përfaqësues të KZAZ-së nr. 53, Përrenjas (S. Kopaçi,
N. Muçmara)

Z. E. Lako: Mirë atëherë, çelim seancën publike për shqyrtimin në themel të Kërkesës Ankimore nr. 45, të depozituar në datën 02.04.2023, nga subjekti zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK”, me objekt “Kundërshtim i vendimit të KZAZ-së nr. 53 të Bashkisë Përrenjas, për mosregjistrimin e listës së kandidatëve “Aleanca Progresiste LZHK” për Bashkinë Përrenjas, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Përpara se të fillojmë shqyrtimin e çështjes, verifikojmë palët pjesëmarrëse, ju lutem duke filluar nga ankuesi, identifikohuni.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.04.2023*

Z. F. Topollari, përfaqësues i “Aleanca Progresiste LZHK”: Fabian Patollari, përfaqësuesi i subjektit “Aleanca Progresiste LZHK”, më autorizim nga Kryetari i partisë.

Z. S. Kopaçi, përfaqësuesi i KZAZ-së, nr. 53, Përrenjas: Saimir Kopaçi, sekretari i KZAZ-së nr. 53 Përrenjas, Narti Muçmara, kryetar i KZAZ-së nr. 53 Përrenjas.

Z. E. Lako: Faleminderti! Palë të interesuara nuk ka. Të pranishëm siç e shihni janë, trupa e KAS-it, administrata e përfaqësuar nga Sekretari i përgjithshëm. Ka ndonjë kërkesë paraprake nga palët lidhur me përbërjen, ndonjë konflikt interesi te mundshëm apo ndonjë kërkesë tjetër?

Z. F. Topollari, përfaqësues i “Aleanca Progresiste LZHK”: Jo i nderuar.

Z. E. Lako: As nga KZAZ-ja nuk ka besoj.

Z. S. Kopaçi, përfaqësuesi i KZAZ-së, nr. 53, Përrenjas: Jo.

Z. E. Lako: Atëherë zoti Sekreta i Përgjithshëm shkurtimisht dy fjalë lidhur me këtë çështje.

Z. Y. Merkaj: Atëherë, pranë KQZ-s është depozituar kërkesa ankimore nr. 45, me ankues “Aleanca Progresiste LZHK”, e cila kundërshton vendimin me nr. 53, Bashkia Përrenjas, me numër 20, dt. 30.03.2023, ora 21:05, e cila ka vendosur mosregjistrimin e listave të kandidatëve të LZHK-së për Bashkinë Përrenjas, me arsyetimin se mungon vërtetimi nga këshilli bashkiak për zotërim mandati, si dhe

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.04.2023*

mungojnë nënshkrimet në dokumentacionin e kandidimit të Rigels Karriqit dhe Alketa Hoxha. Kundër këtij vendimi, duke mos qenë dakord ka bërë ankim “Aleanca Progresiste LZHK”, e cila pretendon se këto dy arsyetime nuk janë të vërteta, pasi LZHK-ja ka dorëzuar pranë KZAZ-së një vërtetim të kuvendit për zotërim mandati si dhe dokumentet e kandidimit të dy kandidatëve janë në përputhje me kodin Zgjedhor. Çeta ka kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore dhe është përpara KAS-it. Faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Sekretar i Përgjithshëm, sipas rradhës ankuesi shkurtimisht në lidhje me përmbajtjen e ankimit.

Z. F. Topollari, përfaqësues i “Aleanca Progresiste LZHK”: Po i nderuar, jemi njoftuar nëpërmjet njoftimit drejtuar përfaqësuesit të “Aleancës Progresiste LZHK” në qytetin e Përrenasit, nëpërmjet njoftimit 32 protokoll, të KZAZ-sw 53 Përrenjas, të datës 30.03.2023, që kjo KZAZ ka refuzuar regjistrimine listës shumëmemërore për këshillin bashkiak të Aleanca Progresiste LZHK me dy arsyetime. Arsyetimi i parë është se mungon vërtetimi nga këshilli bashkiak për zotërimin e mandatit për zotërimin e mandatit sepse ky vërtetim është fotokopje dhe jo origjinal dhe e dyta mungon dokumentacioni origjinal për tre prej kandidatëve, Janë depozituar fotokopje dhe disa prej tyre nuk janë nënshkruar nga kandidatët dhe ato që kandidatët, dokumentacioni i të cilëve pretendohet që janë me mangësi, janë dy në fakt jo tre, Rigels Karriqi dhe Alketa Hoxha. E kemi kundërshtuar këtë vendim brenda afatit ligjor si të pabazuar në ligj dhe në prova. Së pari Kodi Zgjedhor shumë qartë e parashikon që ka raste që subjekti zgjedhor ka mangësi në dokumentacion, atij i lihet një afat për plotësimin e këtyre mangësive, një afat prej 48 orësh, gjë që nuk është lënë në këtë rast nga ana e

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.04.2023*

KZAZ-së, por direkt është pritur që të përmbushen afatet dhe të refuzohet lista, por gjithashtu jo vetëm nuk është lajmëruar për të plotësuar ndonjë mangësi nëse do të kishte një të tillë, por në gjykimin tonë, sipas provave që kemi depozituar, të dyja këto pretendime janë të pasakta. Pretendimi se mungonte vërtetimi nga kuvendi për zotërimin e mandatit nuk është i saktë. “Aleanca Progresiste LZHK” ka depozituar pranë KQZ-së që është organi epror i gjithë KZAZ-ve vërtetimin origjinal të Kuvendit të Republikës që zoti Dashamir Shehi është përfaqësues i kësaj partie politike në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Në fakt për hir të së vërtetës kemi patur probleme edhe gjatë procesit të dorëzimit të dokumentacionit në KZAZ-të e tjera sepse të gjithë e kërkonin këtë vërtetim në mënyrë të mëvetshme dhe mbaj mend që atëherë jam lidhur me administratën e KQZ-së dhe kam kërkuar që të përpilohej një listë me gjithë subjektet zgjedhore dhe të njoftoheshin KZAZ-të që zotërojnë mandat, që është e pamundur që ne të merrnim nga Kuvendi aq kopje origjinale të zotërimit të mandatit sa edhe KZAZ ka në gjithë Shqipërinë. Ne e konsiderojmë të ezauruar zotërimin e mandatit për sa kohë të vetmin vërtetim që kemi, origjinal e kemi depozituar brenda afateve ligjore pranë KQZ-së dhe në gjykimin tonë është kjo e fuqndit që duhet t’ia komunikonte zotërimin për afatin e këtij vërtetimi të gjithë KZAZ-ve. Është një vërtetim i vetëm që vlen njësoj për të gjithë KZAZ-të. Në rastin konkret ne e kemi çuar në formën fotokopje sepse origjinalin e kemi dorëzuar në KQZ dhe të gjithë KZAZ-ve jua kemi çuar në formën fotokopje. KZAZ-ja Përrenjas nuk e quan këtë fotokopje dhe nuk ka denjuar të pyesë as në KQZ nëse ne zotërojmë ose jo mandat, por direkt me këtë arsyetim pra ka refuzuar listat. Gjithashtu pretendimi se mungon dokumentacioni i kandidatëve Rigels Karriqi dhe Alketa Hoxha nuk është i vërtetë. Fatmirësisht këta kandidat përpara depozitimit të dokumentave kanë bërë një skanim të këtyre dokumentave, të cilat unë i kam në formë të skanuar edhe në celulari tim, por një

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.04.2023*

kopje të tyre jua kam vënë në dispozicion. Janë të gjithë dokumentet që kërkon Kodi Zgjedhor, Pra është një kopje e kartës së tyre të identitetit , është deklarata e pranimit të kandidimit, e firmosur në mënyrë të rregullt nga të dy këta kandidatë dhe formulari i vetëdeklarimit për gjendjen e kriminalitetit, e firmosur në mënyrë të rregullt nga të dy kandidatët. Edhe njëherë në gjykimin tonë KZAZ-ja ka vepruar në kundërshtim me Kodin Zgjedhor sepse edhe nëse pretendimi i tyre do të ishte i vërtetë ata e kishin detyrim që ti linin një kohë subjektit zgjedhor për të plotësuar mangësitë në dokumentacion, siç e parashikonte edhe Kodi Zgjedhor në mënyrë shumë specifike. Nuk ka ndodhur kështu, por në kundërshtim me faktet dhe provat, sepse edhe zotërimi i mandatit ekziston, është depozituar në KQZ edhe dokumentacioni i këtyre dy kandidatëve është i plotë. Gjithsesi KZAZ-ja e ka rrëzuar dhe nëpërmjet ankmit tonë ne kërkojmë ndryshimin e këtij vendimi dhe regjistrimin e listës shumëmemërore të subjektit zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK” në qytetin e Përrenjasit për Këshilla Bashkiak.

Z. K. Bele: Faleminderit zoti Patollari. Nga KZAZ-ja.

Z. S. Kopaçi, përfaqësuesi i KZAZ-së, nr. 53, Përrenjas: Atëherë, nuk është fare i vërtetë pretendimi i palës tjetër sepse KZAZ-ja nr. 53 në datën 28.03.2023 ka njoftuar palën me shkresën me numër protokolli 24 dhe konkretisht në kërkesën për plotësim dokumentacioni ne i kemi vënë në dijeni palët se disa prej kandidatëve formularin e vetdeklarimit nuk e kanë firmosur në të gjitha vendet e përcaktuara. Gjithashtu për sa i përket Rigels Karriqit dhe Alketa Hoxhës, dokumentacioni i tyre është fotokopje, nuk është dokumentacion origjinal. Përrenjasi është një vendi i vogël dhe nga verifikimet e bëra të dy këta dy persona

**Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.04.2023*

nuk ndodhen në Shqipëri. Besoj se kjo është shumë lehtë e vërtetueshme. Nëqoftëse do të shohim në sitemin TIMS këta dy persona ndodhen jashtë.

Z. E. Lako: Pretendimet që nuk ndodhen në Shqipëri i keni verifikuar tani mbrapa apo ndodhen në librin e protokollit kur keni bërë verifikimin e dokumentacionit. Domethënë do të flasim për çfarë ju keni konstatuar atë ditë dhe çfarë është shkruajtur në librin e protokollit të mbledhjeve. Domethënë cilat janë shkaqet që nuk kanë çuar në regjistrimin e kësaj liste. Vetëm për ato.

Z. S. Kopaçi, përfaqësuesi i KZAZ-së, nr. 53, Përrenjas: Shkaqet që ne morëm vendimin për mosregjistrimin e subjektit LZHK ishin dokumentacioni fotokopje dhe jo origjinal prej kandidatëve për anëtar këshilli në Këshillin Bashkiak Përrenjas. Disa prej formularëve të vetdeklarimit nuk ishin të firmosur, u rregulluan pasi ne i dërguam shkresën e parë. Disa prej tyre u rregulluan, ndërkohë që ngeli pa u rregulluar formulari i vetdeklarimit për Rigels Karriqin dhe Alketa Hoxhën dhe për këtë arsye ne dolëm me vendim për mosregjistrimin. Gjithsesi doja ta theksoja pjesën që pala është njoftuar. Ka patur gjithë kohën e nevojshme në dispozicion për ta rregulluar të gjithë dokumentacionin dhe nuk e ka bere. Shkresa i është dërguar në mënyrë zyrtare.

Z. E. Lako: Shkresa që ja keni dërguar, ka marrë njoftim pala? Pra ka sjellë... ju thatë që ka rregulluar një pjesë...

Z. S. Kopaçi, përfaqësuesi i KZAZ-së, nr. 53, Përrenjas: Një pjesë po.

Z. E. Lako: Kush ja ka rregulluar?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.04.2023*

Z. S. Kopaçi, përfaqësuesi i KZAZ-së, nr. 53, Përrenjas: Në kërkesën e parë ne kemi kërkuar që kandidatët... Anila Pasho Bogdani është emër i përsëritur dhe kjo pjesë është rregulluar.

Z. E. Lako: Kush i ka rregulluar pra? Që të kuptojmë që e kanë marrë si njoftim apo jo?

Z. F. Topollari, përfaqësues i “Aleanca Progresiste LZHK”: Po e kanë marrë si njoftim se përderisa e kanë rregulluar dhe kanë sjellë dhe një listë tjetër të re...

Z. E. Lako: Kush është ai që e ka sjellë?

Z. S. Kopaçi, përfaqësuesi i KZAZ-së, nr. 53, Përrenjas: Më fal, zoti Fari Laçka. Është përfaqësuesi i këtij subjekti zgjedhor.

Z. E. Lako: Pra përfaqësuesi i subjektit që mban marrëdhëniet me KZAZ-në tuaj e ka marrë njoftimin dhe ka bërë një ndryshim të pjesshëm, që nuk është konsideruar nga KZAZ-ja si i mjaftueshëm dhe ju keni marrë vendim për të mos e regjistruar. Pak a shumë kështu është. Keni gje tjetër?

Z. F. Topollari, përfaqësues i “Aleanca Progresiste LZHK”: Jo, faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit! Pyetje nga kolegët, po zoti Rusmali.

Z. I. Rusmali: Kur i dhatë afat subjektit, Sa kohë afat i dhatë?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.04.2023*

Z. S. Kopaçi, përfaqësuesi i KZAZ-së, nr. 53, Përrenjas: Shkresa për plotësim dokumentacioni është bërë në datën 28.03.2023 dhe plotësimi i dokumentacionit, regullimi i tij është sjellë në datën 30.03.2023, kur ishte dhe dita e fundit.

Z. I. Rusmali: Dakord! Kujt ja keni adresuar shkresën?

Z. S. Kopaçi, përfaqësuesi i KZAZ-së, nr. 53, Përrenjas: Shkresën ja kemi drejuar zotit Fari Laçka. Personi i autorizuar i partisë “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, adresa... ne kemi vendosur adresën tek zarfi. Adresën e morëm nga telefoni sepse nuk e kishte.

Z. I. Rusmali: Mund ta disponojmë ne atë shkresë, një kopje?

Z. S. Kopaçi, përfaqësuesi i KZAZ-së, nr. 53, Përrenjas: Po patjetër!

Z. F. Topollari, përfaqësues i “Aleanca Progresiste LZHK”: Edhe unë kam nevojë për një kopje të kësaj shkrese.

Z. I. Rusmali: Edhe pala tjetër patjetër një kopje. Kush ka qenë në dijeni... Meqenëse dy kandidatë kanë mbajtur dokumentacion fotokopje deri më sot apo jo?

Z. F. Topollari, përfaqësues i “Aleanca Progresiste LZHK”: Jo kanë dorëzuar dokumentacion origjinal, absolutisht. Fotokopje i kam bërë unë atë të skanuarin që ata e kanë dorëzuar të formës origjinale, që jua kam sjellë ju, madje në celular e kam me ngjyra. Siç është origjinali por...

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.04.2023*

Z. I. Rusmali: Fotokopja mund të jetë edhe me ngjyra, nuk do të thotë gjë. Skanimi është me ngjyra, nuk do të thotë gjë. Çështja është se këtu jemi përpara situatës. Po thoshim që për dy nga ata persona KZAZ-ja ka prishur dokumentat e kandidimit, ka marrë origjinalët, i ka fotokopjuar dhe ka lënë fotokopjet brenda sepse nuk ka shpjegim tjetër.

Z. F. Topollari, përfaqësues i “Aleanca Progresiste LZHK”: Po mund të jemi edhe para kësaj situatë.

Z. I. Rusmali: Mund të jemi përpara kësaj situatë?

Z. F. Topollari, përfaqësues i “Aleanca Progresiste LZHK”: Mund të jemi përpara kësaj situatë.

Z. I. Rusmali: Çfarë thoni ju për këtë akuzë që ju bëhet?

Z. S. Kopaçi, përfaqësuesi i KZAZ-së, nr. 53, Përrenjas: Kjo është absurde sepse personi i autorizuar kur ka marrë procesverbalin e dorëzimit të dokumentacionit ka firmosur që është dakord me atë procesverbal. Në procesverbal është bërë e ditur që dokumentacioni është fotokopje. Nëqoftëse do të kishte ndodhur kjo nga ne atëherë ai nuk do e firmoste. Nuk qendron kjo gjë.

Z. F. Topollari, përfaqësues i “Aleanca Progresiste LZHK”: Ajo që pretendon pala është që formati i formularit të dekriminalizimit nuk është me ngjyra, por është një fotokopje, por jo se... Firmat janë fotokopje, nuk ka asnjë procesverbal të

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.04.2023*

tillë që plotësimi është fotokopje. Nuk po kuptohemi. Ata pretendojnë që gjithë dokumentacioni i LZHK-së në fillim është dorëzuar fotokopje.

Z. L. Braho: Sot i keni origjinale këto të dyja? Sot i posedoni, apo i keni dorëzuar në KZAZ?

Z. F. Topollari, përfaqësues i “Aleanca Progresiste LZHK”: Unë i posedoj origjinalet të skanuara dhe janë dorëzuar në KZAZ. Ajo që mua më ka ardhur e formës së skanuar është dorëzuar origjinale në KZAZ. E plotësoj origjinale nuk është asnjë problem, është e njëjta gjë. Unë kam sjellë një kopje të dokumenteve origjinale që kemi dorëzuar në KZAZ. Në procesverbal shkruhet që Rigelsi dhe ajo tjetra i kane dokumentacionet fotokopje?

Nga salla, pa mikrofon, nuk dëgjohet.

Z. E Lako: Kam unë një pyetje për përfaqësuesin e KZAZ-së. Sot siç janë dokumentat, ka ndonjë pengesë nga ju për të vazhduar me regjistrimin e këtij subjekti? Kushti që vërtetimi nuk ka qenë origjinal besoj u sqarua dhe nuk e di si është gjendja. Sot me gjendjen e dokumentacionit që ekziston, pra që është dorëzuar nga subjekti, ju çfarë pengese keni sot për të vazhduar me regjistrimin? Keni ndonjë gjë tjetër të paqartë ose ndonjë dokument që mungon?

Z. S. Kopaçi, përfaqësuesi i KZAZ-së, nr. 53, Përrenjas: Formulari i zotit Rigels Karriqi është fotokopje, në të gjithë dosjen që është dorëzuar është fotokopje, pa e skanuar. Të gjitha, emër mbiemër...dhe pjesën e dosjes ne e kemi dorëzuar në KQZ sipas afatit.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.04.2023*

Z. L. Braho: Fabjan ky...e ka procesverbalin? Ky ka shkruar emër mbiemër këtu...

Z. F. Topollaj, përfaqësuesi i “Aleanca Progresiste LZHK”: Origjinale dhe unë i kam sjellë origjinale. Të skanuara, për efekt largësie nuk i kam fizikisht. I sjell nesër në mëngjes.

Z. I. Rusmali: Problemi që ne duhet të shohim këtu është...se kjo është procedura jonë... ne duhet të shohim se ku e kanë shkelur ligjin këta të komisionit zonal dhe mbi këtë bazë ne gjykojmë. Ne duhet të identifikojmë shkeljet e ligjit nga komisioni zonal. Më thuaj dot se ku e kanë shkelur ligjin këta? E kanë shkelur tek afati që ju kanë dhënë 48 orë kohë? E kanë shkelur që kanë pritur dy herë? E kanë shkelur që kanë qenë korrekt me konstatimet sepse nuk është e vërtetë, nuk mund të jetë e vërtetë që këta kanë marrë dokumentet origjinale, i kanë fotokopjuar, jua kanë grisur origjinalet dhe kanë lënë këto, sepse përfaqësuesi i autorizuar i juaji konfirmon gjetjen e këtyre, ka hedhur firmën. Tani na ndihmo të gjejmë në shkelje këta njerëz që të të japim të drejtë ty. Kjo është logjika e gjësë. Ata nuk janë komision. Punojnë nga mëngjesi deri në darkë që ne ti themi mirë keni punuar ju, tani nuk pyesim për ju. Ne do të bëjmë një gjë tjetër. Nuk është kjo logjika e gjësë. Ata kanë bërë detyrën. Na e thuaj ku e kanë shkelur, ti tërheqim vërejtje, t’ua korigjojmë shkeljen. Kaq është puna jonë.

Z. F. Topollaj, përfaqësuesi i “Aleanca Progresiste LZHK”: Shkelja është në faktin që ata kanë pasë detyrimin që të përcaktonin se cilat janë mangësitë në mënyrë të qartë dhe të plotë dhe më pas nëse ne nuk i plotësonim mangësitë të

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.04.2023*

mund të na refuzoj lista. Unë si përfaqësues i subjektit bashkë me Faikun nuk kam asnjë shpresë që të më qartësohet se cila është mangësia ime që të mund ta korigjoja. Cila është mangësia ime, ma thoni dot?

Z. I. Rusmali: Faiku e ka shkresën.

Z. F. Topollaj, përfaqësuesi i “Aleanca Progresiste LZHK”: Cila shkresë?

Z. I. Rusmali: Ka dy procesverbale marrjesh në dorëzim në të cilat këta kanë shënuar mangësitë. Në deklaratat e pranimit të kandidimit herën e parë, kanë konstatuar katër deklarata fotokopje dhe kanë kërkuar që këto të ndryshohen. Kanë konstatuar në librin e procesverbalit që një kandidat.. sepse nuk mund ta konstatojnë deklaratën e marrjes në dorëzim, se duhet të futesh në themelin e gjësë...Kanë konstatuar se një kandidat mbante funksionin kandidat për dy subjekte. Nuk e lejon ligji këtë punë, nuk e mbajnë dot apo jo?

Z. F. Topollaj, përfaqësuesi i “Aleanca Progresiste LZHK”: Po dakord!

Z. I. Rusmali: Dhe këtë ia kanë komunikuar përfaqësuesit...

Z. F. Topollaj, përfaqësuesi i “Aleanca Progresiste LZHK”: Ne kemi korigjuar çdo gjë.

Z. I. Rusmali: Dakord, por ju keni korigjuar një pjesë të gjërave.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.04.2023*

Z. F. Topollaj, përfaqësuesi i “Aleanca Progresiste LZHK”: Cila është shkresa që më...? Në gjykimin tonë ne i kemi korigjuar të gjitha, ato që kemi kuptuar ne që ishin të nevojshme për tu korigjuar. Tani cila është shkresa që mua më lajmërohet që zoti Rigels dhe zonja Hoxha në mos gaboj kanë këtë mangësi që unë të mund ta plotësoja. Nuk kam asnjë shkresë të tillë.

Z. I. Rusmali: Me mua nënkupton partinë, jo veten tënde. Partia jote në atë zonë elektorale është trupëzuar tek Fariu. Me çfarë shkrese ia keni komunikuar Fariut këto mangësi ju lutem?

Z. S. Kopaçi, përfaqësuesi i KZAZ-së nr. 53, Përrenjas: Sikurse thashë edhe pak më parë, në datën 28.03.2023 ne i kemi dërguar shkresën me numër protokolli 24 zotit Fari Laçka, përfaqësues i subjektit zgjedhor “LZHK”. Pasi është konstatuar një emër i përsëritur i një subjekti tjetër zgjedhor. Përveç kësaj ne kemi konstatuar se në disa formularë të vetëdeklarimit nuk ishin të firmosur në të gjitha fletët. Gjithashtu është konstatuar edhe formulari i vetëdeklarimit... ose i gjithë dokumentacioni ka qenë fotokopje për Rigels Karriqin dhe për Alketa Hoxhën. Në datën 30.03.2023 përfaqësuesi i këtij subjekti zgjedhor ka sjellë listën e korigjuar dhe gjithashtu ka sjellë dhe formularët e vetëdeklarimit dhe dokumentacionin e firmosur në të gjitha fletët për personat e konstatuar. Në këtë datë ky person nuk ka sjellë formularët origjinal që ne i kemi kërkuar për Rigelsin dhe për Alketën.

Z. L. Braho: Janë dy apo një fotokopje sepse në procesverbal thuhet se është një fotokopje.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.04.2023*

Z. S. Kopaçi, përfaqësuesi i KZAZ-së nr. 53, Përrenjas: Për dy persona dokumentacioni është fotokopje.

Z. L. Braho: Ai procesverbali, ai i datës 30...

Z. F. Topollaj, përfaqësuesi i “Aleanca Progresiste LZHK”: Në datën 30 kanë marrë vendimin e refuzimit këta, duhet të më lajmëronin që në datën 27 cilat ishin mangësitë.

Z. L. Braho: Në datën 30 thotë për 4 kandidatë plotësuese njëra nga deklaratat fotokopje përsëri, pra njëra thotë është fotokopje në datën 30. Keni konfirmuar dhe faktin që është ndryshuar lista shumemërore. Pra mbetet një fotokopje. Vet procesverbali, ky i datës 30. Pra është 1 fotokopje apo 2?

Z. S. Kopaçi, përfaqësuesi i KZAZ-së nr. 53, Përrenjas: Në datën 30 ka ardhur lista e korigjuar dhe mendoj... nuk e di nëse jam shumë i saktë por mendoj se mbase njëri prej personave që kemi sepse janë dy fotokopje, është tek lista e korigjuar, por për Rigelsin nuk kemi marrë asnjë dokument origjinal. Dokumentet që na solli përfaqësuesi ligjor i këtij subjekti ishin me whatsapp dhe me email.

Z. F. Topollaj, përfaqësuesi i “Aleanca Progresiste LZHK”: Unë kam vetëm një kërkesë. Unë dua të di a ka një njoftim që Rigels... meqë mbetëm vetëm tek Rigelsi tani, nuk e ka të plotësuar dokumentacionin dhe këtë njoftim unë duhet ta kem të pakën 48 orë përpara vendimit të rrëzimit apo jo? Këtë njoftim dua unë, për këtë mangësi se për të tjerat biem dakord që jemi në rregull, që i kemi korigjuar.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.04.2023*

Z. S. Kopaçi, përfaqësuesi i KZAZ-së nr. 53, Përrenjas: Është njoftimi me numër protokolli 24, i datës 28.03.2023.

Z. F. Topollaj, përfaqësuesi i “Aleanca Progresiste LZHK”: Për shtetasin Rigels Karriqi.

Z. S. Kopaçi, përfaqësuesi i KZAZ-së nr. 53, Përrenjas: Në të cilin konstatohet se aty ka dokumentacion ftokopje. Njëri ndër ta është Rigelsi. Unë nuk e di nëqoftëse duhet të bënim njoftim për kandidatët veç e veç.

Z. F. Topollaj, përfaqësuesi i “Aleanca Progresiste LZHK”: Çdo mangësi duhet të bëhej në gjykimin tim në mënyrë të veçantë që ne ta specifikonim mangësinë. Në rastin më të mirë jemi të paqartë se kush ka qenë mangësia që të kishim mundësi ta korigjonim atë.

Z. S. Kopaçi, përfaqësuesi i KZAZ-së nr. 53, Përrenjas: Fariu ka qenë prezent pranë KZAZ-së nr. 53 dhe ky vendim nuk u mor brenda 3 minutash, por u mor brenda një jave. Fariu ka qenë disa herë atje, ku i janë konstatuar disa herë parregullsitë që ka patur tek lista deri në momentin që ai e korigjoi atë. Ndërsa për Rigelsin, meqenëse personi ishte jashtë shtetit dhe ai nuk mund ta sillte dokumentacionin original ai sugjeronte të ndryshonte listën dhe ta hiqte emrin e këtij personi, në mënyrë që ne të dilnim me vendim pranimit.

Z. E. Lako: Keni ndonjë pyetje tjetër?

Trupa e KAS-it: Jo.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.04.2023*

Z. E. Lako: Mirë atëherë, përfundimisht çfarë kërkoni nga KAS-i secila nga palët?

Z. F. Topollaj, përfaqësuesi i “Aleanca Progresiste LZHK”: Nga KAS-i kërkoj ndryshimin e vendimit të KZAZ-së Përrenjas. Regjistrimin e listës. E theksoj edhe njëherë, nuk kemi qenë asnjëherë të njoftuar për mangësinë në dokumentacionin e shtetasit Rigels Karriqi, që është detyrim i KZAZ-së. Po ashtu kam vënë në dispozicion të administratës ditën e ankimit dokumentet e firmosura në mënyrë të rregullt nga zoti Rigels Karriqi.

Z. S. Kopaçi, përfaqësuesi i KZAZ-së nr. 53, Përrenjas: Atëherë ne si KZAZ, unë personalisht si kryetar i saj, kërkoj lënien në fuqi të vendimit me nr. 20, datë 30. 03. 2023, ora 21:05, për arsye se pretendimet e palës akuzuese nuk qendrojnë. Afatet janë respektuar nga KZAZ-ja për nga kuadri ligjor. Është njoftuar 2 herë me shkresë. Shkresa e parë në datën 28.03.2023, në të cilën i kërkohej... edhe lënda e shkresës ka qenë kërkesë për plotësim dokumentacioni. Nuk mund të pretendohet se nuk janë vënë në dijeni për parregullsitë që kanë sepse nëse do të ishte kjo përse e ndryshuan listën?! Do të thotë që njoftimi i ka shkuar, ata e kanë marrë dhe kanë ndryshuar listën. Pavarësisht se morën njoftimin në datën 28.03.2023 përsëri nga subjekti zgjedhor nuk është plotësuar kërkesa për të sjellë dokumentacionin për njërin prej kandidatëve për anëtar të Këshillit të Bashkisë Përrenjas.

Z. E. Lako: Mirë faleminderit! KAS do të tërhiqet për vendim. Në orën 14:45 do të mbledhemi përsëri për të shpallur vendimin.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.04.2023*

Rifillon seanca

Ora 14:47

Z. E. Lako: Atëherë çelim seancën. Në mbështetje të shkronjës d, të pikës 1 të nenit 143, të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, me shumicë votash Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 45, dt. 02.04.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Aleaca Progresiste LZHK”
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 20, dt. 30.03.2023 të KZAZ-së nr. 53, Bashkia Përrenjas.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e tij. Me kaq kjo seancë deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 50

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

**DATA 06.04.2023
Ora 14.56**

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 46, datë 04.04.2023 të
depozituar nga z. Çlirim Hoxha”**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaç, Znj. I. Osmanaj.
- **Parti politike:** KZAZ nr. 72


Z. I. Rusmali: Hapim seancën për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore, numër 46, të paraqitur nga zoti Çlirim Hoxha. Prezent është trupa e KAS-it në përbërje të plotë, është sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me ekipin e tij, dhe janë, gjithashtu, prezent, si në seancën paraprake, ju lutem, prezantohuni edhe një herë për nevojat e procesverbalit. Ankuesi?

Z. Ç. Hoxha: Çlirim Hoxha, kandidat i propozuar nga zgjedhësit, në KZAZ-në numër 72, të Bashkisë së Bilishtit.

Z. R. Cane: Roland Cane, kryetar i KZAZ-së nr. 72.

Znj. E. Haxhi: Enida Haxhi, sekretare, e KZAZ-së numër 72.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Z. I. Rusmali: Faleminderit! Dhe anëtarët?

Z. A. Hoxha: Altin Hoxha, zëvendëskryetar i KZAZ-së numër 72.

Z. Sh. Cane: Shkëlqim Cane, anëtar i KZAZ-së numër 72.

Z. B. Kanina: Bledar Kanina, anëtar i KZAZ-së numër 72 Devoll.

Z. I. Rusmali: Faleminderit! Nëse ju, si anëtarë të KZAZ-së, që jeni në rreshtin e dytë, nëse keni nevojë të ndërhyni gjatë këtij debati, ju mund ta kërkonit fjalën dhe ne jua japim mundësinë të ndërhyni, përndryshe, pastaj jeni të mirëpritur të rrini aty. Tani duhet të përsërisim edhe njëherë pyetjen: a ka ndonjë kërkesë paraprake para se ne të fillojmë shqyrtimin në themel? Pra, mos ndonjëri nga ju ka ndonjë kundërshtim për trupën?

Znj. E. Haxhi: Jo, nuk kemi.

Z. I. Rusmali: Nuk keni asnjëri. Kolegët nuk kanë deklarime për të bërë kështu që futemi drejtpërdrejtë në shqyrtimin në themel. Si relator, moderator i kësaj seance, do t'ju kërkoja që mundësisht të përqendrohemi te gjërat esenciale, që kanë lidhje me çështjen, dhe të mos përhapemi me gjithçka që ndodh atje në zonën tuaj. Zoti Hoxha, na thoni pak, në themel, tani në thelb, cilat janë pretendimet që keni ju?

Z. Sh. Hoxha: Si propozim i komisionit nismëtar, në KZAZ-në numër 72, si i propozuar si kandidat për zgjedhjet e pushtetit vendor për Bashkinë e Devollit,

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

konfirmova gatishmërinë time, i propozuar nga 9 anëtarë të komisionit nismëtar, ose të komitetit nismëtar, për të marrë pjesë si kandidat i pavarur ose i propozuar nga zgjedhësit në zgjedhjet e qeverisjes vendore që do të kryhen më 14 maj të vitit 2023. Komisioni ose komiteti nismëtar mblodhi firmat dhe në fund, kur pashë që nuk kishte asnjë parregullsi në mënyrën e mbledhjes së firmave, pranova propozimin e tyre për të qenë kandidat i propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet e qeverisjes vendore. Ia kam paraqitur edhe dokumentet e mia, së bashku me firmat, që përbëheshin nga 395 firma KZAZ-së numër 72 Devoll. Në mënyrë jo shkresore, në mënyrë verbale, më datën 28.03.2023, m'u konfirmua se KZAZ-ja numër 72, Bashkia Devoll më kishte regjistruar si kandidat, i propozuar nga zgjedhësit, për zgjedhjet e qeverisjes vendore, me 4 vota pro dhe me 3 vota kundër. Më datën 03.04.2023 , marr një njoftim të dytë nga KZAZ-ja numër 72 se kjo KZAZ nuk ka arritur të marrë vendim për kandidimin tim megjithëse në protokollin në raportin e kësaj KZAZ-je rezultati i votimit ka dalë 4 vota pro dhe 3 vota kundër. Duke parë reagimet në medie, kam marrë konfirmimin nga anëtarët e komitetit nismëtar se procesi i mbledhjes së firmave ka qenë konform ligjit për zgjedhjet e pushtetit qendror dhe lokal në Shqipëri dhe pas këtij konfirmimi, duke parë se nuk kishte asgjë të parregullt, të gjitha ishin kryer në konform me ligjin, i drejtohem Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe KAS-it për të dhënë një vendim përfundimtar në lidhje me kandidimin tim si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet e qeverisjes vendore në Bashkinë e Devollit. Për momentin këto kam. Nëse palët kanë pretendime...

Z. I. Rusmali: Faleminderit, zoti Hoxha! KZAZ-ja nuk është palë kundërshtare në këtë. Ju jeni tanët, ju jeni pjesë e një trupe komisionit që administron zgjedhjet në Shqipëri, kështu që ju nuk keni nevojë të mbani qëndrim me prapësime ose jo.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

 3

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Kështu që jeni këtu për të na ndihmuar që ne ta kujtojmë gjënë dhe ka shumë gjëra që ju mund të na i sqaroni ne. Prandaj, ndoshta, zoti kryetar, nëse përqendrohemi te kjo çështje, cili ka qenë debati lidhur me dokumentacionin e kësaj kandidature, pse ka ngjallur zhurmë brenda jush atje midis jush kjo gjë?

Z. R. Cane: Faleminderit! Më datën 28 ne kemi marrë në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga kandidati i propozuar nga zgjedhësit, zoti Çlirim Hoxha. Pa filluar shqyrtimin e dokumentacionit të sjellë nga zoti Çlirim, në zyrën e KZAZ-së mbërrin kandidati i koalicionit “Bashkë Fitojmë”, zoti Hajdërlli, duke pretenduar se kishte disa dëshmi të marrë tek noteri për firmat për firmëtarët që kishte sjellë komiteti nismëtar. Asnjëri, përveç kandidatit dhe komitetit nismëtar, nuk kishte dijeni se kush ishin ato lista, sepse ne nuk i kishim afër t’i shqyrtonim. I kam thënë unë kandidatit të koalicionit që i solli listat zotëri, ti ke shkuar te noteri pa e ditur se kush ka firmosur, si kanë firmosur këta tani edhe te noteri, kur ti i ke marrë dëshmitë te noteri kur nuk..

Z. I. Rusmali: Kryetar, më falni, që të ndërpres, por ndoshta mund ta koncentrojmë pak, nuk ka nevojë për dialogjet midis njerëzve, por të kapim thelbin. Thelbi është që kishte një pretendim për një numër firmash. Sa ishin ato?

Z. R. Cane: Ishin 8 deklaratat noteriale dhe disa deklaratat noteriale ishin me nga 2 vetë. Që te deklaratat e parë, që unë pashë, njëri deklaronte që ne na është falsifikuar firma. Nuk mund të shkohet te noteri..

Z. I. Rusmali: Pa koment, pretendime për falsifikim të firmës.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

 4

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Z. R. Cane: Duke parë numrin e firmave ne duke parë numrin e nënshkrimeve që na kishte paraqitur komiteti nismëtar dhe që ishin 395, plus 9 firmat e komitetit nismëtar bëheshin 404. Po i zbresim këto 16 që janë të kontestuara, prapë numri i nevojshëm i nënshkrimeve e kalonte 1%-shin e zgjedhësve, sepse ne kemi 33729 zgjedhës, domethënë i binte 3938 nënshkrime, duhet të ishin të konfirmuara. Numri i nënshkrimeve ishte 405, minus 16, mbeteshin 389, pra ishte më i madh se numri i domosdoshëm për t'u kualifikuar, prandaj...

Z. I. Rusmali: Mendimi kundër cili ishte?

Z. R. Cane: Mendimi kundër i 3 komisionerëve të djathtë ishte: meqenëse këta 16 kanë deklaruar që ne nuk i verifikonim dot janë apo jo, meqenëse këta pretendonin që këta 16 janë të kontestuara, të gjitha janë të kontestuara. Pra, ishte një qëndrim absurd, që nuk mund të qëndronte.

Z. I. Rusmali: Pa komente për gjërat vetëm thelbin.

Z. R. Cane: Ky ishte thelbi i debatit.

Z. I. Rusmali: Debatimi është bërë për 16 identitete me 16 nënshkrime.

Z. R. Cane: Të gjitha listat e nënshkrimeve ishin të nënshkruara me kartat e identitetit përkatëse. Dhe karta e identitetit përkatëse janë të gjitha të firmosura me shkrim dore, të gjitha kartat e identitetit janë të nënshkruara, edhe fotokopjet e kartave, kështu që ne i quajtëm të mirëqena. I hodhëm në votim me 4 vota pro dhe 3 kundër.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

 5

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Z. I. Rusmali: Çështje tjetër të ngritur rreth kësaj praktike praktikës së këtij kandidati pati?

Z. R. Cane: Jo, përveç se për këto 16, nuk pati çështje tjetër.

Z. I. Rusmali: Ne me siguri do të kemi pyetje, por është e mjaftueshme për momentin. A mund të dëgjojmë pak sekretaren? Ju lutem, dhe ju me këtë lloj përqendrimi pa u shpërndarë, pra ndalu vetëm te thelbi i debatit. Me mikrofon të lutem!

Znj. E. Haxhi: Unë dua të shpjegoj vetëm rrethanat e ngjarjes atë se çfarë ndodhi në mbledhjen e datës 28 mars në KZAZ-në numër 72. Ne kemi filluar mbledhjen për të shqyrtuar kërkesat e partive politike, që kishin depozituar listat shumemërore së bashku me tri kërkesa të tjera për kandidat për kryetar bashkie. Gjatë kohës së zhvillimit të mbledhjes, në momentin që po bëhej shqyrtimi i dokumentacionit të kandidatit të pavarur, zotit Çlirim Hoxha, anëtarët e komisionit të KZAZ-së, të cilët janë edhe këtu të pranishëm, patën dyshimet e tyre se pse të gjitha listat ishin të nënshkruara me të njëjtin shkrim. Ky ishte dyshimi i parë që i bënë ata të dyshonin te personat që kishin nënshkruar.

Z. I. Rusmali: Të lutem, edhe një herë listat të nënshkruara me të njëjtën dorë ishin të nënshkruara, jo të shkruara? Pra, të shkruara apo të nënshkruara, se janë dy gjëra të ndryshme?

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Znj. E. Haxhi: Të gjithë emrat e firmëtarëve ishin shkruar me të njëjtin shkrim, pra emrat e personave.

Z. I. Rusmali: Por, jo firmat?

Znj. E. Haxhi: Jo firmat.

Z. I. Rusmali: Kjo është e qartë.


Znj. E. Haxhi: Në këtë moment dy anëtarët e KZAZ-së, Jetnor Meka dhe zoti Dritan Zaçe, të cilët janë këtu në atë moment kanë bërë disa telefonata të këtyre personave, i kanë marrë aty gjatë mbledhjes dhe iu kanë thënë nëse keni dijeni dhe janë nënshkrues të këtyre listave. Ata kanë thënë: jo. Anëtarët si përfaqësues politikë të forcës politike Partia Demokratike apo të koalicionit Bashkimi për Fitore, kanë vënë në dijeni kandidatin, i cili ka kontaktuar edhe ai, nga ana e tij këta persona, të cilët janë paraqitur para noterit dhe ne gjatë mbledhjes...

Z. I. Rusmali: Kjo është lista që tha kryetari?

Znj. E. Haxhi: Po.

Z. I. Rusmali: Dakord, ta kalojmë të gjithë këtë histori se kjo është pjesa e antipastës, kalojmë të pjata kryesore dhe merremi me këto 8 deklarata noteriale me 16 ose më shumë persona. Patët diskutimin për këtë çështje?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

P.  7

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Znj E. Haxhi: Po. Duke qenë se komisioni ka detyrimin të kontrollonte 5%-shin e numrit total prej 395 personash, na rezultoi që 18 persona kishin paraqitur deklarata noteriale ku thoshin se...

Z. I. Rusmali: Këta janë 5 % -shi?

Znj. E. Haxhi: Janë depozituar edhe deklarata të tjera. Ne me ankimin..

Z. I. Rusmali: Pyetja është sa është 5%- shi? Apo ta bëjmë vetë llogarinë nuk ka nevojë ta bëni ju. Sa është 5%-shi i listës?

Z. R. Cane: Më pak se 18 zgjedhës.

Z. I. Rusmali: 5%-shi i listët janë 17, dhe anëtarët e komisionit që ngritën kontestimin thanë që këtu jemi te 5%-shi me këto emra?

Znj. E. Haxhi: Jo, ngritën dyshime për manipulim të procesit zgjedhor se dyshuam se një kandidat që ka vendosur kandidaturën për kryetar bashkie paraqitet në KZAZ me një dokumentacion të falsifikuar. Koha ishte e pamjaftueshme, i verifikuan, por kjo lindi dyshime se edhe të tjerë mund të ishin, ashtu sikurse edhe ndodhi. Në ditët në vijim kemi bërë me dije Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Z. I. Rusmali: Të lutem, diskutuat këtë gjë me këtë frymë. Këta 18 persona janë më shumë se 5%-shi, ky 5% rrëzon listën dhe prandaj nuk duhet të regjistrohet. Ky ishte opinionimi alternativ, po themi, ai që ishte i kundërt me kryetarin. Pastaj?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

 8

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Znj. E. Haxhi: Pasi u paraqitën, pra deklaruat noteriale dhe anëtarët e KZAZ-së të ndodhur para këtij fakti, se kemi të bëjmë me një dokumentacion të falsifikuar, vendosën të mos e pranojnë kërkesën për shqyrtim të kandidatit të pavarur duke votuar kundër.

Z. I. Rusmali: Anëtarët që ishin kundër, kishin këtë arsye për të qenë kundër?

Znj. E. Haxhi: Po, dokumentacionin e falsifikuar.

Z. I. Rusmali: A ka pyetje nga kolegët? Po, Zoti Çefa.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Unë kam një pyetje për përfaqësuesit e KZAZ-së. Së pari, këtë verifikimin e 5%-shit të firmave nga lista e paraqitur nga kandidati, e bëtë, e filluat si proces? Pra e keni filluar si proces dhe e keni pasqyruar në një procesverbal dhe si i keni bërë këto përzgjedhjet e emrave për verifikim?

Z. R. Cane: Atëherë, në momentin e fillimit të shqyrtimit administrativ të materialit të sjellë nga komiteti nismëtar, i propozova KZAZ-së të verifikojmë cilin numër të donin, 5, 15, 25, të mbajmë një rend, sepse unë si ekonomist dhe për statistikë kështu veprohet për të bërë një sondazh duhet të merren një seri numrash, për shembull me numër 5, 7.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ia dhashë si alternativë, ia dhashë edhe listat. Këta, tre zotërinjtë, që ishin kundër, më nxorën një fletë me 16 dhe më thanë ja ku i kemi ne që i kemi verifikuar, 16 thanë deklarojnë që nuk kanë nënshkruar. Tani ne nuk jemi ekspertë kriminalistikë që të verifikojmë firmat që a është firma e qytetari apo jo. Ne kemi verifikuar që janë

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 6.04.2023

zgjedhës të asaj zone, kanë kartën e identitetit përkatëse, sepse një 70-vjeçar ose 80-vjeçar që firmosë një herë në muaj për të marrë pensionin, nuk e di që mund ta bëjë firmën të njëjtë çdo ditë. Edhe ne që firmosim na ndryshon firma nga dita në ditë.

Z. I. Rusmali: Kryetar, që të mos shpërndahemi, ju, si komision, ishit në dijeni të udhëzimeve të KQZ-së për procedurën? Çfarë kërkon ajo procedurë? Çfarë qëllimi? Çfarë duhet të realizoni nëpërmjet saj?

Z. R. Cane: Sipas procedurës 5% e nënshkrimeve duhet të verifikoheshin.

Z. I. Rusmali: Për çfarë duhet të verifikoheshin?

Z. R. Cane: Duhet të verifikoheshin që janë zgjedhës të asaj zone, sepse unë nuk jam ekspert kriminalistik për të verifikuar firmat, janë zgjedhës të kësaj zone?

Z. I. Rusmali: Pyetje: Ata 16 persona janë zgjedhës të asaj zone?

Z. R. Cane: Janë zgjedhës.

Z. I. Rusmali: Domethënë këtë e konfirmoni të dyja palët.

Z. R. Cane: Ata janë zgjedhës, por nuk mund të konfirmoj që ata kanë nënshkruar te lista dhe kanë shkuar te noteri...

Z. I. Rusmali: Nuk ka lidhje me pyetjen. Të lutem, mos dil nga pyetja. Në listën e madhe ndonjë nga anëtarët ka konstatuar ndonjë emër që nuk është zgjedhës i zonës?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

 10

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Z. R. Cane: Jo.

Z. I. Rusmali: Në rregull. Ka ndonjë pyetje? Zoti Çefa.

Z. E. Çefa: Kam të njëjtën pyetje, por në version tjetër. Meqenëse pala tjetër, anëtarëve të KZAZ-së, sikurse ju thatë, solli listën e deklaratave noteriale me 16 emra që pretendojnë që pretendojnë që u është falsifikuar firma, ju e vijuat procesin e verifikimit të 5%, apo ndaloi këtu?

Z. R. Cane: Ndaloi këtu, nuk u verifikua më. Nuk u verifikua më, sepse asnjëri nuk ishte i predispozuar nga zotërinjtë që të vazhdonin procedurën, sepse insistonin që meqenëse këta 16, që janë paraqitur, kontenstojnë firmën, nuk shohim të tjera, sepse thoshin që e gjithë lista bie. Ky ishte pretendimi i anëtarëve të tjerë.

Z. E. Çefa: Dakord. Ju e kishit mundësinë që këtë ta linit mënjanë e të vazhdonit verifikimin edhe e disa të tjerëve, por nuk e keni bërë këtë. As ju pjesa tjetër që ishit pro regjistrimit të kandidatit.

Z. R. Cane: Ne i kemi kaluar të gjitha listat dhe të gjithë zgjedhësit që ishin paraqitur janë zgjedhës në moshë mbi 18 vjeç dhe janë zgjedhës të zonës 72. Pjesa tjetër nuk kemi çfarë t'i verifikojmë ne.

Z. E. Çefa: Këtë e keni verifikuar.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Z. R. Cane: Mbas çdo flete që ishte e nënshkruar, kishte edhe kartat e identitetit që kishin firmën e njomë.

Z. E. Çefa: Faleminderit!

Z. I. Rusmali: Sekretare, do të kërkoja diçka përpara që ne ta kuptojmë. Para se të thuash këtë, do ta thuash atë që ke në plan, na shpjego pak në raport me verifikimin e listave, cila është detyra juaj si sekretare, që të kuptojmë ne kontekstin.

Znj. E. Haxhi: Dakord. Në lidhje me pyetjen e parë nëse të gjithë firmëtarët janë ose jo zgjedhës në atë zonë, anëtarët e KZAZ-së kanë verifikuar se disa nga personat që kanë nënshkruar aty janë persona rezidentë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këtë gjë e kanë verifikuar anëtarët e KZAZ-së dhe nga kjo lindi dyshimi, se ata nuk mund të deklaronin te noteri, sepse ata nuk gjenden as në Shqipëri.


Z. I. Rusmali: Këtu ka një gjë që duhet të na e sqaroni me aq sa keni mundësi. Gjysma e shqiptarëve janë rezidentë jashtë shtetit, por figurojnë në listën e zgjedhësve.

Znj. E. Haxhi: Por nuk janë në Shqipëri për të nënshkruar.

Z. I. Rusmali: Ky është diskutim tjetër. Tani po diskutojmë në lidhje me çështjen a janë zgjedhës apo jo.

Znj. E. Haxhi: Po, janë zgjedhës, por nuk kishin nënshkruar ata.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

 12

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Z. I. Rusmali: Shumë mirë. Sa ishin këta persona?

Znj. E. Haxhi: Në total kanë qenë 26 persona, të cilët përbëjnë afërsisht 8% të totalit.

Z. I. Rusmali: 26 persona pa 16-çen.

Znj. E. Haxhi: Në total.

Z. I. Rusmali: Bashkë me 16-çen, domethënë 10 veta të tjerë. 10 veta të tjerë i keni identifikuar ju në atë mbledhje?

Z. R. Cane: Jo në atë mbledhje.

Znj. E. Haxhi: Me shkresën nr. 36 janë dërguar 16 persona dhe me shkresën nr. 42 i është bërë me dije Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në datën 2 prill se totali i deklaratave noteriale është 26, pra i atyre që deklarojnë që nuk është firma e tyre dhe nuk kanë nënshkruar dhe kjo përbën 8% të numrit të përgjithshëm.

Z. I. Rusmali: Shkresa e kujt është?

Znj. E. Haxhi: Është shkresa e KZAZ-së që i është drejtuar KZAZ-së.

Z. R. Cane: Jo e KZAZ-së, se kjo zonja vulën e KZAZ-së e mban te selia e PD-së...

Z. I. Rusmali: Zoti kryetar, zonja ka vulën, ti ke firmën.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023*

Znj. E. Haxhi: I nderuar, këto dokumente i kemi bërë me dije në mënyrë zyrtare Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Komisionerit, po i vë në dispozicion edhe këtu.

Z. I. Rusmali: Zonja sekretare.

Znj. E. Haxhi: Janë dy ankime që i kanë nënshkruar 4 anëtarë nga komisioni...

Z. I. Rusmali: Të lutem, na shpjego pak funksionin tuaj në raport me verifikimin.

Znj. E. Haxhi: Unë kam mbajtur shënim, unë kam mbajtur mbledhjen dhe këtu po shpjegoj...

Z. I. Rusmali: Jo, jo, lëre çfarë ke bërë, na ndihmo të kuptojmë. Je sekretare e KZAZ-së. Na shpjego se cilat janë detyrat e tua në raport me këtë procedurë.

Znj. E. Haxhi: Unë kam protokolluar gjithçka që ka mbërritur në Komision, kam mbajtur shënim mendimet pro dhe kundër dhe kam dërguar shkresat pranë Komisionit Qendror.

Z. I. Rusmali: Je zonjë e nderuar, nuk i diskutoj fare këto gjëra, nuk jam duke të atakuar, jam duke të kërkuar ndihmë. Të lutem, unë nuk e njoh punën e sekretarit të KZAZ-së ose të KQV-së, nuk kam qenë kurrë i tillë. Kam nevojë të më ndihmosh të kuptoj në këtë procedurë është sekretari që e menaxhon si proces, është kryetari që e menaxhon si proces, pra kush e menaxhon si proces. Në qoftë se ti thua që unë kam për detyrë që të mbaj protokollin dhe të shënoj gjithçka, është në rregull, kjo është detyra e sekretarit. Në qoftë se sekretari ka detyrë të sqarojë anëtarët për

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

kuadrin ligjor, dakord, kjo është detyra. Pra, unë këtë dua të di. Është vetëm mbajtja e protokollit, apo është më shumë se kaq.

Znj. E. Haxhi: Detyrat e sekretarit janë të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Sekretari jep mendim, jep shpjegime ligjore, sepse prandaj kërkohet që të jetë jurist, ka të drejtë të shprehë mendim, por nuk ka të drejtë të votojë. Unë po shpjegoj çështjen sesi ka ndodhur. Vendimet, mendimet i kanë dhënë anëtarët e tjerë dhe ata kanë bërë edhe shkresat për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Z. I. Rusmali: Të lutem, mos e keqkupto gjënë. Ju është e qartë që keni mbajtur shënim procedurën, keni mbajtur shënim çfarë ka ndodhur. Në qoftë se jepni mendime ose sqarime ligjore, keni dhënë të tilla në këtë rast?

Znj. E. Haxhi: I kam dhënë në shkresën drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Z. I. Rusmali: Në atë mbledhje i keni thënë që bëhet kështu e kështu?

Znj. E. Haxhi: Mendimin e kanë dhënë të gjithë ata anëtarë që kishin të drejtën e votës. I kam dhënë shpjegimet, nuk i kam shkruar sepse nuk u arrit në vendimmarrje.

Z. I. Rusmali: Nuk është fare gabim, të mos keqkuptohemi.

Znj. E. Haxhi: Ju kuptoj. Nuk u arrit në vendimmarrje në mbledhjen e datës 28. Në datën 29, që unë kisha detyrimin për të zbardhur vendimin, e kam bërë gati sipas formatit tip, janë lajmëruar të gjithë anëtarët, kanë mbërritur vetëm 6 prej tyre, 3 kanë nënshkruar pro dhe 3 kanë nënshkruar kundër.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

 15

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Z. I. Rusmali: Ju jeni anëtari...

Z. D. Zaçi: Anëtar komisioni Dritan Zaçi.

Z. I. Rusmali: Dritan Zaçi. Dritan, për çështjen e verifikimit të listave, se këtu kemi ngelur, ke ndonjë gjë të ndryshme nga kjo sa u tha deri tani?

Z. D. Zaçi: Kam diçka plotësuese. Verifikimin e listës nga kryetari i komisionit më është caktuar mua duke ma imponuar për disa herë radhazi, merr dosje shikoje, se unë me sekretaren jam duke bërë diçka tjetër në lidhje me dokumentacionin që përcjell në KQZ. I kam thënë ta bëjmë bashkërisht. Kam parë një insistim nga kryetari dhe më ka bërë të dyshoj. Personi që kam dyshuar tek ajo listë jam unë. Kam parë një listë të shkruar me të njëjtën shkrim të gjitha.

Z. I. Rusmali: Këtë e dëgjuam. Plotësimi i listës është bërë nga një dorë, firmat janë të ndryshme. Kjo është ajo që thoni ju?

Z. D. Zaçi: Po. Gjatë këtij procesi ka përfunduar sekretarja me kryetarin, kemi rënë dakord duke ngritur këto dyshime që verifikimin e firmave do ta bëj unë me kryetarin. Kemi selektuar disa numra, ashtu si e tha kryetari, dhe i kemi verifikuar bashkërisht.

Z. I. Rusmali: Për çfarë i keni verifikuar?

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Z. D. Zaçi: Për dyshimin që kam ngritur unë që kjo listë ishte e përbërë nga i njëjti persona dhe ngrita një dyshim timin personal për ta verifikuar që këta njerëz janë rezidentë, janë njerëz të asaj qendre votimi...

Z. I. Rusmali: Verifikimi që ju kërkohet është nëse janë zgjedhës të zonës. Këtë verifikim e bëtë?

Z. D. Zaçi: Këtë verifikim ishim duke e bërë me kryetarin.

Z. I. Rusmali: Për aq sa e bëtë, si ju doli?

Z. D. Zaçi: Na doli që personi Dritan Zaçi, po marr veten time, është banor i këtij qyteti dhe, duke verifikuar listën e firmave, nuk përputhej firma e listave me firmën te karta e identitetit.

Z. I. Rusmali: Kjo është pjesa tjetër e verifikimit. T'i marrim verifikimet një nga një. Bëtë verifikimin aq sa e bëtë, nuk ka rëndësi, a janë zgjedhës. Përgjigjja ishte janë zgjedhës apo nuk janë?

Z. D. Zaçi: Pasi kemi bërë jo 16 verifikime, më pak se 16 verifikime ky proces është ndaluar.

Z. I. Rusmali: Pse e ndaluat këtë proces?

Z. D. Zaçi: Se nuk i pëlqeu kryetarit të komisionit që ne po debatim për diçka që nuk shkonte në lista.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Z. I. Rusmali: Këta më pak se 16 që verifikuat, ishin zgjedhës?

Z. D. Zaçi: Nuk po arrinim të orientoheshim nga një debat që u krijua nga një imponim që i bëhej sekretares, nga një imponim që u imponohej anëtarëve pse këto vendime i di kryetari dhe kryetari e ka më të qartë akoma.

Z. I. Rusmali: Domethënë ju nuk u morët me verifikimin e listës që janë zgjedhës apo jo, por u morët me këto çështje që nuk korrespondojnë?

Z. D. Zaçi: Qëllimi i listës për verifikim ishte që janë apo nuk janë.

Z. I. Rusmali: Për këtë e ndërpretë po thua dhe u morët me këtë çështjen tjetër? Kjo çështja tjetër cila ishte?

Z. D. Zaçi: Çështja tjetër ishte që në listën që po shikonim kishte mospërputhje të nënshkrimeve.

Z. I. Rusmali: Sa të tilla?

Z. D. Zaçi: Të paktën unë me kryetarin në atë moment kam parë 5 në atë moment.

Z. I. Rusmali: Si e gjetët?

Z. D. Zaçi: Si e gjetëm mund ta hapësh listat nëse i disponon...

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Z. I. Rusmali: Jo, të ma tregosh si e gjete me fjalë, nuk ka rëndësi.

Z. D. Zaçi: Me fjalë duke parë listën dhe deklaratën e personave, duke marrë një kartë identiteti të këtij personi për ta verifikuar.

Z. I. Rusmali: Në shkrime dukej qartazi që ishin të ndryshme, këtë po thua, me sy të lirë.

Z. D. Zaçi: Me sy të lirë është bindur edhe vetë kryetari.

Z. R. Cane: Nuk mundesh ta identifikosh kartën e identitetit me nënshkrimin që...

Z. I. Rusmali: Edhe një herë, njëri-tjetrit mos i flisni në gojë. Zoti kryetar, a është korrekte sa ka thënë zoti Zaçe deri tani?

Z. R. Cane: Ata insistonin vetëm tek ato 8 deklaratat noteriale dhe asgjë më tepër. Këta zotërinjtë e kanë marrë noterin dhe e kanë çuar shtëpi më shtëpi...

Z. I. Rusmali: Kjo është histori tjetër, sepse ka ndodhur jashtë mbledhjes.

Z. R. Cane: Dakord. Ata kanë insistuar vetëm te këto 8 deklaratat noteriale...

Z. L. Braho: Ku e di ti që ka shkruar noteri shtëpi më shtëpi?

Z. R. Cane: E di, sepse është e shkruar në deklaratë.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Z. L. Braho: Si e ka shkruar?

Z. R. Cane: Që ka shkruar me makinën e kandidatit...

Z. L. Braho: Edhe ky personi i makinës është te deklarata?

Z. R. Cane: Bilishti nuk është si Tirana.

Z. I. Rusmali: Dakord, por ju lutem, mos bëni debate me njerëzit. Pra, keni ngecur te 5 firmat që nuk ju korrespondojnë. A ratë dakord me njëri-tjetrit që këto 5 firma...

Z. R. Cane: Jo, nuk ramë dakord, sepse mua më duket e njëjtë, kurse ky zotëria thotë që nuk është e njëjtë, prandaj e kemi dërguar në laborator për ta verifikuar.

Z. I. Rusmali: Gjë tjetër përveç tjetër këtyre 5 firmave. Zoti Zaçi, me ju jam duke folur.

Z. D. Zaçi: Ka diçka tjetër kryetar.

Z. I. Rusmali: Cila është tjetra?

Z. D. Zaçi: Nuk e bindëm dot njëri-tjetrin me mashtrime. Tjetra është kjo, sepse i bëtë një pyetje sekretares, cila është detyra jote.

Z. I. Rusmali: Detyrën e sekretares nuk ma tregon dot ti.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Z. D. Zaçi: Unë do t'ju tregoj se çfarë bëri sekretarja në një mbledhje.

Z. I. Rusmali: Jo, nuk më duhet, sepse sekretarja di vetë. Mua më duhet se çfarë gjete tjetër ti?

Z. D. Zaçi: Unë gjeta një dosje me shkrime dhe nënshkrime të falsifikuara. Domethënë në atë dosje mund të jenë mbi 50 firma që janë të falsifikuara.

Z. I. Rusmali: Firma të falsifikuara. Pse të dalin të falsifikuara?

Z. D. Zaçi: Më dalin, sepse unë në atë moment, pra gjatë debatit që ka bërë kryetari me sekretarin dhe anëtarë të tjerë kam marrë mbi 10 persona në telefon për t'i pyetur nëse ka ndodhur apo jo.

Z. I. Rusmali: Ke marrë 10 persona dhe kjo të çoi në konkluzionin që 50 veta kishin falsifikuar firmat?

Z. D. Zaçi: 50 veta, sepse unë i pashë dhe kam dijeni.

Z. I. Rusmali: I ke parë më mbrapa?

Z. D. Zaçi: Po.

Z. I. Rusmali: Po diskutojmë atë moment, pra momentin kur ju morët vendimin...

Z. D. Zaçi: Në atë moment unë kapa kryetarin...

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Z. I. Rusmali: Momentin kur ju morët vendimin, sepse ne duam të kuptojmë pse keni dalë me atë vendim dhe se çfarë ka ndodhur më pas është histori e ditëve në vijim, nuk është histori juaja dhe e asaj mbledhjeje. Në atë mbledhje më rezulton se deri tani keni debatuar për 8 deklaratat noteriale me 16 persona, keni debatuar për 10 rezidentë në Amerikë, apo jo, si dhe për 5 firma që nuk korrespondojnë. A jam i saktë?

Z. D. Zaçi: Po.

Z. I. Rusmajli: A keni debatuar gjë tjetër në atë mbledhje?

Z. D. Zaçi: Kemi debatuar, duke na u imponuar nga kryetari që sekretarja të shkruajë çfarë thotë kryetari dhe më pas na është dhënë liria edhe ne për të shkruar se çfarë kemi thënë edhe ne...


Z. I. Rusmali: Çfarë keni shkruar ju?

Z. D. Zaçi: ...dhe e kanë mbyllur mbledhjen në atë moment që kemi folur, duke mos i lënë të gjithë të sqaruar.

Z. I. Rusmali: Zoti Zaçe, çfarë keni shkruar ju?

Z. D. Zaçi: Kam shkruar që unë kam gjetur dhe identifikuar me anë të telefonit fillimisht dhe më pas kanë arritur pas një farë kohe deklaratat të nënshkruara nga noteri. Nga ai moment na është komunikuar nga kandidati i forcës “Bashkë fitojmë”

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

 22

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

se ky veprim do të shkojë edhe në prokurori, kështu që unë jam tërhequr nga ky rast, pra për të legalizuar një dokument të falsifikuar.

Z. I. Rusmali: Në rregull. Pra, ju keni marrë informacionin nga jashtë...

Z. D. Zaçi: Jo nga jashtë, sepse kandidati erdhi aty. Nga jashtë ka sjellë dokumentin.

Z. I. Rusmali: Në rregull. Ju jeni barku i shtëpisë, 7 veta, por përveç jush ka ardhur edhe dikush tjetër që ka thënë...

Z. D. Zaçi: Pas verifikimit tonë. Pra, pasi është bërë alarmante, ka ardhur dikush nga jashtë.

Z. I. Rusmali: Mirë. Kolegët, a kanë ndonjë pyetje për këtë çështje?

Z. E. Lako: Kam unë një pyetje, është më shumë për sekretaren, sepse ajo mban librin e protokollit. Ne duhet të gjykojmë këtu mbi provat që janë administruar dhe që janë paraqitur. Në librin e protokollit është shkruar: U mor vendim 4 me 3.

Znj. E. Haxhi: Jo, nuk u mor vendim, ai ishte pohim.

Z. E Lako: Detyrat e sekretarit të KZAZ-së janë të pasqyruar dhe janë të qarta në Kodin Zgjedhor. Një nga detyrat e sekretarit të KZAZ-së është që të pasqyrojë në libër me saktësi dhe vërtetësi çdo fakt dhe çfarë ka ndodhur gjatë mbledhjes së KZAZ-së. Ju pretendoni, ose thoni, nuk e di se çfarë do të deklaroni, që kjo që ju

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

keni shkruar vetë në librin e protokollit nuk ka ndodhur, pra që është marrë një vendim 4 me 3? Kjo është pyetja ime.

Znj. E. Haxhi: Po, e kuptoj. Deri në fazën që unë kam mbajtur protokollin çështja nuk është hedhur për shqyrtim. 4 me 3 është pohim i kryetarit, sepse, pasi kryetari ka thënë 4 me 3, aty thuhet, Roland Cane, pra atë që ka thënë kryetari. Ndërkohë, ka ndërhyrë Dritan Zaçi, është e shkruar, Dritan Zaçi; nuk ka folur Joneli, pra, i referohet anëtarit të 7, sepse ai s'kishte dhënë asnjë mendim, nuk e kishte deklaruar vullnetin e tij, nëse do të ishte pro, ose do të ishte kundër. Këtu pati debat. Ai zotëria, tha që unë tërhiqem nga kjo vendimmarrje, duke u ndodhur para faktit të falsifikimit të dokumenteve, pati frikë të legalizonte apo të merrte pjesë në një proces nga e cili ai mendonte se do të kishte dhe vetë përgjegjësi penale, nëse firmoste për kualifikimin e kandidatit, duke qenë se ishin në kushtet dhe rrethanat e falsifikimit të dokumentacionit, ka lënë mbledhjen dhe është larguar. Faqja e fundit e tregon më së miri, që aty s'ka vendimmarrje, për shembull: në një rast të zakonshëm kryetari do të thoshte: e hedhim çështjen për shqyrtim. Janë të pranishëm kaq persona, kaq persona janë pro e kaq persona janë kundër. Në momentin që anëtari i 7-të u largua dhe në komision mbetën 6 anëtarë me të cilët kishte vendimmarrje...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Z. I. Rusmali: Të lutem, kryetar, prit pak të flas unë, se ne kemi edhe kompetencë të marrim masë disiplinore. Këtu flitet me etikë, flitet me rregull dhe këtu dëgjohen të gjithë. Prandaj, të lutem shumë!

Znj. E. Haxhi: Në procesverbalin e mbledhjes nuk ka një deklaram të kryetarit, të nënkryetarit, apo të dikujt, po në atë rast ishte kryetari që drejtonte mbledhjen, që të

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

P. [Signature]
24

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

thuhej po hidhet çështja në shqyrtim dhe po merret një vendim. Nuk ka një deklaram të tillë. Nëse do të kishte ndodhur kjo, kryetari do të kishte insistuar që unë ta shkruaja, por ai vetë e ka nënshkruar. Faqja e fundit e mbledhjes e vërteton që mbledhja ka ngelur e papërfunduar. Aty kanë nënshkruar vetëm 2 persona, sepse gjithë të tjerët janë larguar në mënyrë demonstrative. Unë si sekretare duke qenë se sipas ligjit të nesërmen e mbledhjes duhet të zbardhja vendimin. ..

Z. I. Rusmali: Enida, të nesërmen e mbledhjes do të shkojmë ne, nuk shkoni ju, dakord. Tani të të pyes pak unë ty, unë po shoh.. Ta bëj këtë pyetje, se ka lidhje me gjënë direkt? Po shoh pak këtë shkresën tënde, që na depozitove tani që është firmosur nga sekretarja dhe nga anëtarët: Jetnor Meka, Dritan Zaci dhe Shkëlqim Cane, e datës 28.03

Znj. E. Haxhi: Këtë e kemi dërguar në KQZ për të shpjeguar çfarë ndodhte.

Z. I. Rusmali: Të lutem, fik mikrofonin dhe me dëgjo pak! Po lexoj paragrafin e parë të shkresës. KZAZ-ja nr. 72 në Bashkinë Devoll, në datën 27.03.2023 ka pranuar për regjistrim kërkesën e kandidatit të pavarur, zotit Çlirim Hoxha. Këtë e ke shkruar ti besoj, apo jo? Kjo nuk e kundërshton atë që the pak më përpara?

Znj. E. Haxhi: Jo, nuk e kundërshton.

Z. I. Rusmali: Nuk e kundërshton.

Znj. E. Haxhi: Jo, nuk e kundërshton. Në momentin kur ne themi e pranon, në kuptimin që kemi marrë

Z. I. Rusmali: Të lutem, përgjigjja mjafton, nuk e kundërshton.

Znj. E. Haxhi: Po jo, pra.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Z. I. Rusmali: Po, pra e mora përgjigjen, dhe tani prit se kolegu ka pyetje për të tjetër.

Z. G. Lako: Në vijim të asaj që po sqaronim, sepse për mua libri është shumë i rëndësishëm se ai pasqyron faktet, se çfarë themi mbrapa nuk ka ndonjë rëndësi. Jo për të kundërshtuar atë që po thoni ju, po çfarë shoh unë në fletën e librit të protokollit ku thuhet që hidhet në votim në KZAZ, po e citoj: “hidhet në votim në KZAZ dhe me 4 vota pro” dhe pastaj vazhdon në fletën tjetër “dhe 3 kundër kandidati regjistrohet”. Pra, në fletën ku thuhet hidhet në votim në KZAZ dhe me 4 vota pro, ekzistojnë të 7 firmat. Pra, nënshkrimet e anëtarëve të KZAZ-së.

Znj. E. Haxhi: Më fal, ai ishte pohimi..

Z. I. Rusmali: Të lutem, mos ndërhy!

Z. G. Lako: Dhe në këtë faqen e fundit, që ju pretendoni që s’ka folur, çfarë ka thënë një anëtar, që s’ka folur Joneli, ne nuk e kemi, në fakt, edhe si komplet fletën, sepse në fund mungon fare kjo që është fotokopjuar, mungon pjesa e nënshkrimeve, nuk e kemi, por t’u referohemi fletëve të tjera të librit, nuk janë mbajtur në çdo fletë të 7 firmat, nënshkrimet e anëtarëve. Për shembull, po t’u referohemi fletëve përpara të së njëjtës mbledhje ekzistojnë 6 firma, 6 nënshkrime. Po të shkojmë përpara, ja edhe te kjo fleta tjetër zëvendëskryetari, për shembull, nuk ka nënshkruar, pra, në një ka nënshkruar, në një nuk ka nënshkruar. Te kjo tjetra, për shembull, ka nënshkruar ky Jonel Bylykbashi, apo zëvendëskryetari mbase ka nënshkruar diku tjetër. Pra, nuk është se të gjitha fletët janë nënshkruar nga të 7 anëtarët, në disa kanë nënshkruar 6 në disa... Dhe po t’i referohemi kësaj të librit, në fletën ku është marrë vendimi, thuhet: “hidhet në votim dhe me 4 vota pro” dhe kanë nënshkruar të 7 anëtarët.

Z. I. Rusmali: 3 nga ata janë shprehur kundër, se kanë vënë shënimin kundër.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

 26

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Znj. E. Haxhi: Ai ishte pohimi i kryetarit. Ai thotë: “hidhet në votim” dhe unë e shënova, por në votim nuk u hodh. Ai tha: “hidhet në votim”, në mënyrë të njëanshme.

Z. I. Rusmali: Të lutem, si e shpjegon ti në këtë fletë, që anëtarët që kanë qenë kundër, kur kanë hedhur firmën në këtë fletë, kanë vendosur shënimin kundër. Në fletët e tjera ky shënim nuk është. Në këtë fletë është shënim, ka tre herë kundër. Pse është vënë kjo kundër në këtë fletë?

Znj. E. Haxhi: Po pra, sepse po kundërshtonin gjithçka që po bëhej në atë mbledhje, sepse po imponohesh nga kryetari dhe shumica.

Z. I. Rusmali: Në këtë fletë, se në fletët e tjera jo, nuk janë kundër. Janë në këtë fletë ku është shpallur ky vendim. Kanë thënë kundër.

Znj. E. Haxhi: Po mbledhja vazhdon edhe në faqen tjetër. Aty nuk është mbyllur mbledhja.

Z. I. Rusmali: Në faqen tjetër nuk ka shënim kundër.

Znj. E. Haxhi: E kuptoj, po vazhdon fjalia, nuk ka mbaruar mbledhja.

Z. I. Rusmali: E qartë.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Z. L. Braho: Te shkresa e datës 28, që i keni dërguar zotit Celibashi, në paragrafin e parë thuhet: “KZAZ-ja nr. 72, në Bashkinë Devoll në datën 27.3. ka pranuar për regjistrim kërkesën e kandidatit”. Çfarë keni dashur të thoni “me ka pranuar”?

Znj. E. Haxhi: Ka pranuar, në kuptimin që është administruar. Ai e ka sjellë dhe ne e kemi administruar, pastaj shpjegoj si e është shqyrtuar dhe çfarë ka ndodhur.

Z. L. Braho: E kuptova, pra është thjesht për dopozitim të letrave.

Znj. E. Haxhi: Po pra, ne e kemi të detyruar të pranojmë gjithçka që na vjen, dhe ne kemi pranuar si dokumentacion.

Z. L. Braho: E kuptoj, thjesht doja ta sqaroja. Te libri i protokollit data e fundit dhe ora e fundit që keni shënuar është data 27.3.2023 ora 11:00. Deri këtu te faqja e fundit janë të datës 27, apo ka kaluar te data 28?

Znj. E. Haxhi: Jo, vazhdon, e njëjta mbledhje vazhdon. Ajo mbledhje ka qenë.


Z. L. Braho: Pra mbledhja e datës 27, kjo është vijuese?

Znj. E. Haxhi: Po vijuese.

Z. L. Braho: Pra keni filluar në 11:00 paradite dhe kur është mbyllur mbledhja?

Znj. E. Haxhi: Mbledhja u mbyll në këtë lloj forme pa arritur këtë vendimin. Ishte vonë, ishte mbas dite, në orën 6, ose 6 e 30- 7 diçka e tillë. Po vonë.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

 28

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Z. L. Braho: Mbledhja ka pasur kuorum gjatë gjithë kohës, kanë gjatë gjithë kohës më shumë se katër anëtarë ose më shumë?

Znj. E. Haxhi: Po, kanë qenë deri në momentin që u paraqitën deklaratat dhe u njohën me faktin e deklaratave noteriale, sepse anëtarët dyshuan në atë moment, por në momentin që u konfirmua, që vetë personat thoshin që ne nuk kemi firmosur, nuk kemi nënshkruar në ato lista, na janë marrë mjetet e identifikimit në mënyrë të paautorizuar, pa dijeni tonë, atëherë mbledhja u prish dhe unë të nesërmen bëra vendimin, sepse duhej të materializohej, Në atë moment erdhën vetë 6 persona, dhe 3 ishin pro, 3 kundër. Këtë vendim e depozitova.

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit! Kam një pyetje për kryetarin.

Z. R. Cara: Mund të sqaroj diçka? Unë si kryetar kam objeksionet e mia. Një sekretare nuk mund ta fillojë protokollin në datën 27 dhe ta mbarojë në datën 29. Ia kam thënë 100 herë kush mban protokollin: zonjë, shkruaj ato që themi. Nise me rendin e ditës të mbledhjes dhe.. Unë nuk mund të mësoj sekretaren se si mbahet protokollin! E fillon me 27 dhe e mbaron me 29 dhe i ka bërë lëmsh, edhe vendimit i vë datën 27, të njëjtit vendim i vë datën 29.

Z. L. Braho: Kryetar, nuk kemi nevojë për këtë. Unë kam një pyetje tjetër: këtu te faqja e parafundit që janë 7 firma, 3 kundër, është edhe një Aurela Cane? Kjo është e pranishme këtu sot?

Z. R. Cara: Nuk është, se na tha nuk është nevojshme për të ardhur.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Z. L. Braho: Kjo nuk ka firmosur te faqja e fundit që është me dy firma, që është firma jote dhe Bledar Kanina, që është këtu. Po. Janë dy firma.

Z. R. Cara: Unë si kryetar e shikoj protokollin dhe i shkoj deri në fund. Kur ua ka dhënë kjo anëtarëve të tjerë për të firmosur, faqen e fundit nuk ua ka dhënë për të firmosur, nuk e ka hapur për ta firmosur faqen e fundit. Unë e kam nënshkruar, se unë e kontrolloj, se kam një jetë që punoj me shkresa dhe nuk mund t’i anashkaloj. Kështu që unë firmën kur e hedh, e hedh me përgjegjësi. Mbledhja është përfunduar me 7 anëtarë, votimi u krye i rregullt me 4 pro dhe 3 kundër. Ajo nuk i ka shkruar të gjitha atje, ka shkruar çfarë ka mundur dhe e ka lënë aty në fund, nuk ka thënë që mbledhja përfundon me këtë. Asnjë nuk e braktisi mbledhjen. Mbledhja u mbyll dhe mbaroi, kjo ishte çështja e fundit e mbledhjes që u miratua. U la që ditën nesërme kjo zonja duhej të na sillte që në mëngjes vendimin, se unë i thashë se është afati i fundit, që nesër duhet t’i çoj në KQZ se i ke vonuar. Kjo na i solli në orën 12:00, duke i bërë presion, ja ku e kam anëtarin, që e merrte natën kjo sekretarja dhe i thoshte: “do të vijë prokurori, po na vijnë prokurorët”.

Z. L. Braho: Kryetar, nuk kemi nevojë për këto historitë me prokurorinë.

Znj. E. Haxhi: Kryetari sapo deklaroi këtu...

Z. L. Braho: Është vazhdimi i pyetjes.

Z. I. Rusmali: Cila është pyetja, që të jemi edhe neve në dijeni të pyetjes.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

Z. L. Braho: Vazhdimi i pyetjes është çfarë ka ndodhur në fund të mbledhjes, pse janë vetëm dy firma?

(Diskutim pa mikrofon)

Z. I. Rusmali: Pse janë vetëm dy firma në fund?

Znj. E. Haxhi: Sepse vërteton atë që po them deri tani, që nuk u krijua shumica e nevojshme, siç thotë Kodi Zgjedhor, që vendimet merren me shumicë votash dhe nuk lejohet abstenim.

Z. I. Rusmali: Pse nuk janë 6 firma në fund?

Znj. E. Haxhi: Sepse të gjithë u larguan në mënyrë demonstrative nga presioni i shumicës, sepse ishin 4 veta dhe kërkonin të impononin vullnetin për nënshkruar vendimin.

Z. I. Rusmali: 4 donin të impononin vullnetin.

Znj. E. Haxhi: Po. Kryetari sapo tha që sekretarja regjistron çfarë do ajo, ndërkohë që kryetari ka nënshkruar në çdo fletë të saj pasi e ka lexuar. Vetëm nëse e ka nënshkruar pa lexuar. Si e ka...

Z. I. Rusmali: Dakord. Ka pyetje të tjera? Jo. Kolegët nuk kanë pyetje. Unë falënderoj Komisionin për sqarimet që na dha, por duhet t'ju falënderoj se pjesa juaj

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.04.2023*

mbaroi këtu. Jemi te pretendimet përfundimtare. Ju, si palë, keni të drejtën të shpreheni për çfarë kërkon nga KAS-i.

Z. Ç. Hoxha: Përderisa disa gjëra u lanë pezull, shkurtimisht jo më shumë se 30 sekonda të kthej përgjigje në lidhje me pse të gjitha listat janë shkruar me të njëjtin shkrim.

Z. I. Rusmali: Jo, nuk ka nevojë, na thuaj çfarë do nga ne.

Z. Ç. Hoxha: Përderisa personat, anëtarë të KZAZ-së nr. 72 kanë vepruar në kundërshtim me nenin 71 të Kodit Zgjedhor, sepse në momentin që kanë bërë raportin nuk kam qenë i pranishëm, është jashtë kompetencave të tyre institucionale të menaxhojnë provat, sepse nuk mund ta marrin si apriori ose të vërtetë që një firmë është false apo jo, kërkoj nga KAS-i rrëzimin e vendimit të KZAZ-së nr. 72 dhe regjistrimin si kandidat i propozuar nga zgjedhësit.

Z. I. Rusmali: Mirë, faleminderit! Atëherë ndonjë kërkesë për të marrë ndonjë provë ose ndonjë gjë tjetër, nuk besoj se keni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Z. I. Rusmali: Jo, ju keni mbaruar punë, ju jeni për informacion këtu. Mbyllim shqyrtimin administrativ të kësaj ankese. KAS-i do të tërhiqet për të marrë vendim dhe vendimin ne do ta shpallim në orën 16:00. Faleminderit!

Rifillon seanca

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.04.2023
ora 16:05*

Z. I. Rusmali: Riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 46. KAS-i diskutoi në tërësi kërkesën dhe pretendimet e parashtruara në këtë seancë. Me shumicë votash ne dalim në konkluzionin (vendimin do t'jua them më pas), që në vlerësimin tonë KZAZ-ja nr. 72 e ka realizuar regjistrimin e kandidatit të propozuar nga komiteti nismëtar, zotit Çlirim Hoxha, por nuk ka përfunduar procedurën e dokumentimit të tij. Për këtë arsye ne vendosim që të pranojmë kërkesën ankimore nr.46, të paraqitur nga zoti Çlirim Hoxha, detyrimin e KZAZ-së nr.72, që ta regjistrojë dhe dokumentojë regjistrimin, në përputhje me ligjin dhe t'ia paraqesë atë KQZ-së sa më parë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit në Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij. Shpallet sot në datën 6 prill 2023. Me kaq e mbyllim seancën. Ju uroj ditë të mbarë!

Vendimi nr. 52

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

